

Të dhëna të reja mbi neolitin dhe eneolitin në Kosovë / *The New Data on the Neolithic and Eneolithic Civilisation of Kosovo*

Adem Bunguri

Citer ce document / Cite this document :

Bunguri Adem. Të dhëna të reja mbi neolitin dhe eneolitin në Kosovë / *The New Data on the Neolithic and Eneolithic Civilisation of Kosovo*. In: *Iliria*, vol. 33, 2007. pp. 51-106;

doi : <https://doi.org/10.3406/iliri.2007.1066>

https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_2007_num_33_1_1066

Fichier pdf généré le 19/03/2019

Adem BUNGURI

**TË DHËNA TË REJA MBI NEOLITIN DHE ENEOLITIN
NË KOSOVË**

Kosova shtrihet në pjesën perëndimore të Ballkanit qëndror dhe përbën një tërësi gjeografike e kulturore me kufij natyrorë mirë të përcaktuar të tij. Ajo kufizohet në jug dhe juglindje me Maqedoninë, në veri dhe në lindje me Serbinë, në veriperëndim me Malin e Zi dhe në perëndim me Shqipërinë. Në kuptimin gjeomorfologjik dhe hapsinor, Kosova përbëhet nga dy depresionet e mëdha tektonike të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Fushës së Kosovës, si dhe nga zona submalore e malore e faqeve periferike të maleve kufizuese që i rrethojnë këto rrafshë fushore. Rrafshi i Dukagjinit përputhet përgjithësisht me pjesën perëndimore të Kosovës. Në pikëpamje gjeografike ai shtrihet nga mali i Sharrit në jug, dhe ai i Koritnikut e Pashtrikut në jugperëndim, që e ndajnë atë përkatësisht me republikën ish jugosllave të Maqedonisë (FYROM) dhe Shqipërinë, deri në malin Mokra në veriperëndim, që e ndanë atë me Malin e Zi, si dhe deri në qafën e Dules, tarracën e Drenicës dhe vargun kodrinor të Carralevës në lindje. Rrafshi i Kosovës shtrihet në pjesën lindore të vendit, nga gryka e Kaçanikut në jug deri në malet e Mitrovicës dhe të Leposaviçit në veri, nga malet Caralevë, Golesh e Çiçavicë në perëndim deri në malet e Zhegovës dhe Koznicës në lindje. Megjithë këtë pamje të mbyllur orografike, Kosova përfaqëson një rajon me frymëmarrje të lirë komunikuese si me bregdetin egjean e atë adriatik, ashtu edhe me brendësinë kontinentale të gadishullit Ballkanik dhe të pellgut të Danubit të poshtëm. Kjo gjë është kushtëzuar nga përshkimi gjatësor i Fushë-Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit përkatësisht nga sistemi lumor Ibër-Sitnicë-Nerodimkë, pjesë e transversales ballkanike Moravë-Vardar, si dhe nga Drini i Bardhë dhe bashkërrjedhësit e tij. Nëpër luginat e këtyre lumenjëve kalojnë pa pengesë rrugët natyrore që e lidhin këtë pellg si me krahinat e Danubit të poshtëm ashtu edhe me ato të Egjeut dhe të Adriatikut. Kjo pozitë e përshtatshme gjeografike, ka ndikuar në përcaktimin e këtij rajoni si zonë kalimtare nga Adriatiku në Ballkanin qëndror dhe njëherësh edhe si zonë kontakti të kulturave adriatikase, egjeane dhe ballkano-qëndrore.

Kërkimet mbi kulturat neo-eneolitike në Kosovë kanë një moshë mjaft të re dhe ndahen në dy faza:

Faza I përputhet me veprimtarinë e Muzeut të Kosovës pas luftës II botërore, dhe përfshin periudhën nga krijimi i këtij institucioni në vitin 1949 deri në fundin e viteve 90', kur veprimtaria e tij kërkimore-shkencore praktikisht kishte pushuar (1949-1999). Kjo veprimtari intensifikohet veçanërisht në vitet 60-80' të shekullit të kaluar, kur u kryen gërmime arkeologjike në një sërë vendbanimesh neo-eneolitike, si në Glladnicë dhe në Tjerrtorë (Predionicë) të Prishtinës, në Zhitkovac, Vallaç, Karagaç dhe në Fafos (fabrika e fosfatit) të luginës së Ibrit pranë Mitrovicës, në Rudnik të Skënderajt, në Hisar dhe Reshtan të Rrafshit të Dukagjinit, në Gadime të Lipjanit. Gjithashtu në këtë periudhë u zbuluan edhe disa vendbanime të reja neolitike nga gjetjet sipërfaqësore (Gërncar pranë Vitisë)¹, punimet ndërtimore (Batovc pranë Prishtinës) apo survej të organizuar (Vlashnje e Prizrenit)². Gjatë kësaj periudhe, kanë dhënë kontributin e tyre të vlefshëm në fushën e studimit të qytetërimeve neo-eneolitike të Kosovës arkeologët R. Galoviaç, J. Todoroviaç, M. Garoanin, A. Benac, N. Tasiaç, J. Gliciaç, B. Jovanoviaç, N. N. Tasiaç³ etj. Duke filluar nga fundi i viteve 70' të shekullit të kaluar, në studimet neo-eneolitike të Kosovës, u përfshinë edhe arkeologë shqiptarë si E. Shukriu Hoti⁴ dhe pas viteve 2000 edhe T. Kastrati⁵ e Sh. Gashi⁶.

¹ J. Gliciaç, *Rezultatet me të reja për parahistorinë e Kosovë-Metohisë*, "Përparimi", revistë kulturore, nr. 11-12, Prishtinë 1957, f.737.

² M. Garoanin-J. Kovaceviciaç-E. Æerskov-J. Gliciaç, *Gradishta vendbanim shumështrësor parahistorik, antik dhe mesjetar*. Prishtinë 1964, Arkivi i Muzeut të Kosovës.

³ R. Galoviaç, *Predionica, Neolitsko Naselje kod Priçitine*, Muzej Kosova i Metohije Priçitina, Priçitina 1959; M. Garoanin, *Centralnobalkanska zona, Starcevska grupa*, PJZ, II Sarajevo 1979, f. 123-137; A. Benac, *Južna Metohija, Prelazna Zona*, Neolitsko Doba, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja, II Sarajevo 1979, f. 456-460; J. Gliciaç-B. Jovanoviaç, *Praistorisko naselje na Gladnicama kod Gračanice, Sondažno Rekagosciranje 1956*, GMKM, II, Prishtina 1957, f. 223-233, tab. I-V ; N. Tasiaç, *Žitkovac i neki problemi relativnog hronološkog Neolitskih i Eneolitskih naselja na Kosovu i u dolini Ibra*, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, III, Priština 1958, f. 11-47, tab. I-X; N. Tasiaç, *Završna Istraživanja na Praistorijskom Naselju kod Valaëa*, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, IV-V, Priština 1959-1960, f. 11-52, tab. I-XXV; Po ai, *Introduction to the prehistory, antiquity and early Middle Ages in Kosovo and Metohija*, Arheološko Blago Kosova i Metohije od neolita do ranog credneg veka, Beograd 1998, f. 23; Po ai, *Neoliti i ri në Kosovë e Metohi*, "Përparimi", revistë kulturore, nr. 3, korrik 1955, f.145-151, J. Gliciaç, *Rezultatet me të reja për parahistorinë e Kosovë-Metohisë*, "Përparimi", revistë kulturore, nr. 11-12, nëntor-dhjetor 1955, f. f. 734-740; N. N. Tasiaç *The Starëevo Culture, ATK and Metohija from the Neolithic to the Early Middle Age*, Beograd 1998. f. 35-55.

⁴ E. Shukriu-Hoti, *Kërkimet arkeologjike përgjatë rrjedhës së poshtme të Drinit të Bardhë, Iliria VII-VIII, 1977-1978*, f. 189-195; Po ajo, *Fortifikata "Hisar" në Kasterc të Suharekës*, Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike, nr. 16, Prishtinë 1987, Po ajo, *Dardania paraurbane*, Prishtinë 1996, f. 11-15; Po ajo, *Kosova antike*, Prishtinë 2004, f.10-12.

⁵ T. Kastrati, *Kërkimet arkeologjike në Kosovë*, Seminari III Ndërkombëtar "Shkodra në shekuj"(16-17 .11. 1998), Shkodër 2000, f. 13-15; Po ai, *Vendbanimi neolitik i Bardhoshit*(Gërmime të vitit 2002), Sesioni shkencor , Tiranë 2002; Po ai, *Vendbanimi neolitik i Bardhoshit*(temë e masterit), Tiranë 2004.

⁶ Sh. Gashi, *Vendbanimi prehistorik i Hisarit*, disertacion, Prishtinë 2008.

Faza II e kërkimeve në këtë fushë të arkeologjisë prehistorike përfshin vitet 2000-2008 e në vazhdim. Gjatë kësaj kohe në Rrafshin e Dukagjinit u kryen sondazhe të vogla në shpellën e Radacit (Pejë) e atë të Zatriçit (Rahovec), në vendbanimin prehistorik të Pogrades (Klinë) si dhe u ndërmorën gërmime të regullta arkeologjike në Hisarin e Suharekës, në Vlashnje të Prizrenit si dhe në Nishor të Suharekës. Në Fushën e Kosovës u kryen gërmime me karakter shpëtimi në vendbanimin neolitik të vonë të Bardhoshit në rrethinën e Prishtinës. Rezultatet e këtyre gërmimeve, kanë sjellë të dhëna të reja, që pasurojnë më tej njohuritë tona mbi tiparet e qytetërimit neo-eneolitik të këtij rajoni.

Sipas të dhënave arkeologjike, rezulton se territori i Kosovës ka qenë banuar që në periudhat më të hershme të parahistorisë⁷, falë kushteve mjaft të favorshme gjeoklimatike dhe tokësore të tij. Qytetërimi neolitik dhe eneolitik është relativisht mirë i përfaqësuar dhe i studiuar, pavarësisht se kultura e vendbanimeve përkatëse akoma nuk është vënë plotësisht në qarkullim shkencor⁸ (fig. 1).

Në këtë artikull do të japim një vështrim të përgjithshëm mbi tiparet kryesore të këtij qytetërimi në hapësirën e Kosovës, duke u përqëndruar kryesisht në të dhënat më të reja të përfuara nga gërmimet tona të viteve të fundit në Rrafshin e Dukagjinit, që u referohen këtyre dy epokave⁹.

I. Neoliti

Kultura neolitike e Kosovës njihet sot nga rreth 20 vendbanime të shtrirë në të gjithë hapësirën e saj. Të tillë janë Rudniku dhe Rakoshi (Skënderaj), Gjonaj dhe Vlashnja (Prizren),

⁷ Gjurmët më të hershme të kulturës prehistorike në pellgun e Drinit të Bardhë i përkasin epokës së paleolitit. Të dhënat arkeologjike që lidhen me të janë mjaft të varfëra e të pamjaftueshme. Është fjala këtu vetëm për disa gjetje rastësore të zbuluara në sipërfaqen e shpellës së Radacit dhe të vlerësuara si paleolitike. Ato përbëhen nga disa eshtra kafshësh parahistorike, dhe një pjesë e nofullës me dhëmbë e ariut të shpellës (*ursus spelaeus*). Shih: M. Garašanin, *Praistorija na tlu Srbije I*, Beograd 1966, f. 10. Gjurmët të kësaj epoke janë ndeshur dhe në shpellën e Markut (Pejë) dhe në disa shpella të tjera në rrethinën e Pejës, si në shpellën e Zezë, shpellën e Kallabës, shpellën e Shkëmbit të Kuq dhe në dy shpella pranë Jabllanicës së Madhe, por fatkeqësisht të pa shoqëruara me dokumentacionin përkatës arkeologjik. Shih: M. Ivanoviæ, *Kulturna Bashtina Kosova i Metohije*, i Deo (od praistorije do XII veka) Starinar, Kosova i Metohija, Kniga X, Prishtinë 1977, f. 10. A. Bunguri, *Pellgu i Drinit të Bardhë në Prehistori*, Harta arkeologjike e Kosovës, I, Prishtinë 2006, f. 27.

⁸ J. Glisiæ, "Kosova nekad i danas", Prishtinë 1973; M. Garaceanin, *Centralnobalkanska zona, Starævska grupa*, PJZ, II, Sarajevo 1979, f. 123-137; A. Benac, *Južna Metohija, Prelazna Zona*, Neolitsko Doba, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja, II Sarajevo 1979, f. 456-460; N. N. Tasiè, *The Starævo Culture, ATK and Metohija from the Neolithic to the Early Middle Ages*, Beograd 1998, f. 35-55; M. Garaceanin, *The Vinæa Culture and the Adriatic Influences, ATK and Metohija*,..f. 61-87.

⁹ A. Bunguri-Sh. Gashi, *Raport mbi gërmimet e viteve 2003-2004 në Hisar*, Arkivi i Institutit Arkeologjik, Prishtinë, Tiranë; Po ata, *Raport mbi gërmimet në vendbanimin e Vlashnjës të viteve 2002, 2006-2008*, Arkivi i Institutit Arkeologjik, Prishtinë, Tiranë; A. Bunguri, *Pellgu i Drinit të Bardhë në Prehistori*, Harta arkeologjike e Kosovës, I, Prishtinë 2006, f. 27-40; Po ai, *Tipare të qytetërimit neo-eneolitik në Rrafshin e Dukagjinit (Kosovë)*, Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare (18-20.12. 2008), Tiranë 2009, f. 301-315.



Fig. 1. Hartë e vendbanimeve neo-eneolitike të Kosovës.

Hisari dhe Reshtani (Suharekë), Çupeva e ulët (Klinë), Kramoviku dhe Saroshi (Rahovec), Tjerrtorja, Glladnica, Batovci dhe Bardhoshi (Prishtinë), Fafosi, Zhitkovaci, Lushta dhe Valaçi (Mitrovicë), Gënçari (Viti), Barileva (Podujevë), Parteshi dhe Klllokoti (Gjilan), Nerodime (Ferrizaj) etj. Ata janë të vendosura në fusha aluvionale apo tarracore të sheshta pranë luginave lumore, përkatësisht në pellgjet ujëmbledhës të Drinit të Bardhë, të Sitnicës, të Ibrit, të Llapit, Moravës së Binçës apo Nerodimkës dhe ndonjë prej tyre edhe në tarraca lumore (Hisari), kodrinore (Vlasknja) apo shkëmbore (Valaçi). Prej tyre janë gërmuar Tjerrtorja (1955-1956), Vallaçi (1955-1956), Fafosi (1957-1958), Rudniku (1966-1968, 1984), Çupeva e Ulët (1968-1969), Hisari (1961-1963, 1978, 2003-2004, 2007), Zhitkovaci (1956), Glladnica (1956, 1959)¹⁰, Reshtani (1963, 1967-1968), Bardhoshi (2002) si dhe vendbanimi shumështrësor i Vlasknjës (2002, 2006-2008).

Në pikëpamje të kronologjisë relative kultura neolitike e Kosovës njihet sot përmes sistemit triperiudhësh të saj, përkatësisht neolitit të hershëm, neolitit të mesëm dhe atij të vonë.

1. Periudha e neolitit të hershëm

Kultura e kësaj periudhe njihet në Kosovë nga 9 vendbanime, 6 prej të cilëve në Rrafshin e Dukagjinit. Në pikëpamje topografike, janë përfaqësuar të dy tipet klasike të vendbanimeve të neolitit të hershëm, si ai i vendosur në fusha të sheshta aluvionale buzëlumore (Gjonaj, Çupevë e Ulët, Kramovik, Glladnicë, Zhitkovac) apo në rrafshet

¹⁰J. Glisic-B. Jovanovic, *Praistorisko naselje na Gladnicama kod Graëanice, Sondažno Rezagosciranje 1956*, GMKM, II, Pristina 1957, f. 223-233, tab. I-V ;

respektive(Rudnik, Rakosh), që mbizotëron, ashtu edhe ai i vendosur në tarraca të sheshta buzëlumore (Vlashnje), pranë rrugëve të rëndësishme natyrore. Në nivelin e sotëm të njohurive, rezulton se kultura e periudhës së neolitit të hershëm është zhvilluar nëpërmjet tri fazave suksesive kronologjike:

a. Faza I më e hershme është ajo paraklasike, ose faza Rudnik I, që në pikëpamje kronologjike përputhet me fazën proto-Starçevo-Starçevo I. Kjo fazë njihet stratigrafikisht në Rudnik I, ndërsa nga zbulimet e rastit në Gjonaj të Prizrenit. Në këtë fazë mund të përfshihet me rezervë edhe vendbanimi i Batovcit pranë liqenit të Batllavës të Prishtinës, kultura e të cilit njihet fare pak.

b. Faza II klasike kronologjikisht më e vonë, i referohet zhvillimit klasik të neolitit të hershëm, dhe përputhet me fazat Starçevo II a-b. Ajo është konstatuar stratigrafikisht në Rudnik II-III, Rakosh, Çupevë e Ulët, Kramovik, Vlashnje I(Prizren), Glladnicë Ia, Zhitkovac I.

c. Faza III ose Rudnik IV i korespondon fazes fundore të neolitit të hershëm në këtë rajon që përputhet me atë Starçevo III të Ballkanit qendror. Në këtë fazë përfshihen faza Rudnik IV dhe ajo Glladnicë I b.

a. Faza I e neolitit të hershëm (Rudnik I).

Vendbanimet e kësaj faze janë vendosur në rrafshje pllajore (Rudnik) apo fusha të sheshta aluivionale buzëlumore(Gjonaj). Nga tri vendbanimet e kësaj faze, vetëm Rudniku është studiuar përmes gërmimesh sistematike.

1. Rudnik(Skënderaj)

Është vendbanimi më i rëndësishëm i neolitit të hershëm të zonës qendrore të Kosovës. Ai gjendet në fshatin eponym, afër Skënderajt, në rrafshet e faqes jugore të tarracës së Drenicës dhe përfshihet në pellgun ujëmbledhës të Drinit të Bardhë. Gërmimet sistematike të viteve 1966-1968 të drejtuara nga J. Gličič, u plotësuan edhe me një gërmim kontrolli në vitin 1984¹¹. Në kushtet kur rezultatet e tyre mbeten ende të pabotuara, në literaturën arkeologjike vazhdon të përdoret periodizimi i M. Garaćanin i vitit 1979¹². Sipas vlerësimit stratigrafik dhe kronologjik të tij, kultura e Rudnikut zhvillohet nëpërmjet 4 fazave të emërtuara Rudnik I-IV¹³, prej të cilave fazat Rudnik I-III i takojnë kulturës Starçevo I-II, dhe faza Rudnik IV, një shtrese të hollë midis kulturës Starçevo III dhe asaj Vinča-Tordosh I.

Faza Rudnik I karakterizohet nga një kulturë e tipit protostarçevo-Starçevo I dhe përfshihet në neolitin e hershëm të Ballkanit qendror. Banesat e këtij horizonti

¹¹ N. N. Tasić, *The Starævo Culture*, "ATKM, from the Neolithic to the Early Middle Ages, Beograd 1998, f. 49.

¹² M. Garaćanin, *Centralnobalkanska zona, Starævaæka grupa*, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja, II, Neolitsko Doba, Sarajevo 1979, f. 134-136.

¹³ M. Garaćanin, *Centralnobalkanska zona, Starævaæka grupa*, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja II, Sarajevo 1979, f. 135-136.

kronologjikisht më të vjetër kanë qenë të ndërtuara mbi tokë, me skelete druri, pa dysHEME, ashtu si edhe në Burim I.

Kultura e kësaj faze përcaktohet nga qeramika trashanike, ku shquhen dy kategoritë kryesore të saj, qeramika impresso dhe më pak ajo barbotine, si dhe qeramika e hollë monokrome e kuqe me lustër, pa qeramikë të pikturuar. Format më të pëlqyera të enëve janë ato sferike e gjysëm-sferike me funde unazorë, dhe vegjë kryesisht tunelore, shpesh vertikalisht të tejshpuara. Këto elementë kulturorë të kujtojnë në përgjithësi tiparet e fazës më të hershme të grupit kulturor të Starçevos (Starçevo I)¹⁴, me të cilën lidhet pa dyshim edhe kultura e Rudnikut I, qoftë dhe si një variante periferike juglindore e saj. Lidhur me kronologjinë relative të kësaj shtrese M. Garashanin, mendon se faza Rudniku I i korespondon fazës protostarçevo, por akoma nuk mund të thuhet me siguri nëse ai e paraprin fazën Anzabegovo-Vrsnik I dhe është më afër Proto-Sesklos, apo përfaqëson një kulturë më të vonë¹⁵. Megjithëse materialet e Rudnikut akoma nuk janë publikuar, gjë që e vështirson një analizë krahasuese më të hollësishme të tyre, paralelizmi kronologjiko-kulturor i horizontit më të hershëm të tij Rudnik I me qeramikë impresso, barbotine dhe monokrome të kuqe pa pikturim, me atë protostarçevo dhe Starçevo I, vështirë se mund të vihet në dyshim.

2. Gjonajt

Vendbanimi i Gjonajt¹⁶ ndodhet në tokat aluvionale të fshatit eponym, në vendin e njohur me emrin “Livadhet e Gjovit”, në krahun e djathtë të Drinit të Bardhë, shumë afër vendbanimit të Vlashnjës (Prizren) dhe atij të Kolshit (Kukës). Qeramika e zbuluar nga punimet bujqësore ruan tiparet morfologjike e stilistike të fazës proto-Starçevo dhe Starçevo I, që përputhet me fillimet e neolitikit të hershëm ose me fazën Rudnik I. Ajo karakterizohet nga qeramika me fakturë të trashë e përbërë nga dy kategoritë bazë të saj, ajo barbotine që është më e shumtë dhe ajo impresso, si dhe nga qeramika monokrome e kuqe, me fakturë të hollë, numerikisht më e paktë, në të cilën mungon plotësisht qeramika e pikturuar¹⁷. Me këto tipare kultura e Gjonajt sinkronizohet me atë Rudnik I (Skënderaj) si dhe me atë Burim I (Dibër) dhe përfshihet në fazën protostarçevo dhe Starçevo I të neolitikit të hershëm ballkano-qendror.

3. Batovc.

Vendbanimi gjendet afër Glladnicës dhe liqenit me ujë të pijshëm të Batllavës së Prishtinës. Nga punimet për ndërtimin e këtij liqeni në vitet 80’ të shekullit të kaluar, qenë gjetur aty 3 sëpata guri të tipeve të hershme neolitike¹⁸, por jo qeramikë. Njera

¹⁴ Po aty, f. 136.

¹⁵ Po aty, f. 136.

¹⁶ E. Shukriu-Hoti, *Kërkimet arkeologjike përgjatë rrjedhës së poshtme të Drinit të Bardhë, Iliria VII-VIII, 1977-1978*, f. 192.

¹⁷ F. Prendi-Zh. Andrea, *Të dhëna të reja mbi neolitikin në Shqipëri, Iliria 1981*, 2, f. 19.

¹⁸ Κάδαεοᾶ, *Αρχειοεοφοκο Ἀεᾶᾶο Κοκοᾶᾶ ἔ Μεδοxεᾶε οᾶ Ιεοεᾶᾶ εο πανοᾶ cpeᾶᾶεᾶ ᾶεκα*, Beograd 1998, nr. 47.

prej këtyre sèpatave është tipologjikisht shumë e ngjashme me sèpatat e shtresës më të hershme neolitike të Lepenski Virit¹⁹, analogji që na shtyn për të supozuar praninë në Batovc të një shtrese shumë të hershme kulturore që do t'i referohej fazës më të hershme të neolitit të hershëm, por kjo mbetet hipotetike përderisa nuk është provuar nga gërmimet arkeologjike.

Faza II e neolitit të hershëm

Përfaqëson zhvillimin klasik të kësaj kulture në Kosovë. Në Rrafshin e Dukagjinit ajo është konstatuar në shtresat Rudnik II-III dhe Vlashnje I, si dhe në Kramovnik, Rakosh dhe në Çupevë e Ulët, ndërsa në Rrafshin e Kosovës në Glladnicë I a dhe Zhitkovac I. Në pikpamje kronologjiko-kulturore ajo përputhet me fazat Starçevo II a-b të neolitit të hershëm ballkano-qëndror.

1. Rudnik II-III

Në shtresën Rudnik II²⁰ vazhdojnë të jenë në përdorim kategoritë qeramike të horizontit më të hershëm, por tani në qeramikën monokrome të kuqe shfaqet për të parën herë dekori i pikturuar. Në fillimet e horizontit Rudnik II shfaqet qeramika fine e pikturuar me ngjyrë të bardhë mbi sfond të kuq e tipit Starçevo II a-Anzabegobovrsnik I²¹, ndërsa në nivelet e sipërme të kësaj shtrese qeramika e pikturuar me ngjyrë kafe mbi sfond të kuq me motive linearo-geometrike e tipit Starçevo II b²²(*tab.I. 1-enë me dekor të pikturuar kafe mbi të kuq*). Karakteristikë për këtë fazë janë gjithashtu objektet e lidhura me botën shpirtërore të banorëve neolitikë, përkatësisht tavolinat e kultit, figurinat antropomorfe etj. Kjo fazë përkon me ekspansionin më të madh të kulturës Starçevo në drejtim të jugut, të përfaqësuar nga horizonti Rudnik II, Vlashnje I, Kolsh I etj²³. Analogjitë e mësipërme tregojnë se në këtë periudhë të hershme të zhvillimit prehistorik, i gjithë Rrafshi i Dukagjinit ishte pjesë e arealit të gjerë ballkano-qëndror të neolitit të hershëm të tipit Starçevo II a-b. Në fazën Rudnik III përmirësohet cilësia e qeramikës së pikturuar në të gjithë treguesit e saj, dhe shtohet frekuenca e

¹⁹ D. Srejavica, *Protoneolit-Kultura Lepenski Vira*, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja, II, Neolitsko Doba, Sarajevo 1979, f. 57, tab. VIII, 2-3.

²⁰ Sipas disa studieve Rudnik II i takon neolitit të mesëm ballkano-qëndror. Shih për këtë : N. N. Tasić *The Starçevo Culture*, "ATKM, from the Neolithic to the Early Middle Ages, Beograd 1998, f. 51.

²¹ M. Garacëanin, *Centralnobalkanska zona, Grupa Anzabegovo-Vrsnik*, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja II, Sarajevo 1979, f. 90, fig. 9, nr. 1-3, tab. XIII, 6; Po aty, *Starëvevačka grupa...* f. 125, tab. XIX, 1-2.

²² M. Garacëanin, *Centralnobalkanska zona, Starëvevačka grupa*, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja II, Sarajevo 1979, f. 126, fig. 11, nr.12..

²³ F. Prendi, Zh. Andrea, *Të dhëna të reja mbi neolitit në Shqipëri*, Iliria 1981, 2, f. 18-19, tab.I-III; M. Korkuti, *Vendbanimi neolitik i Kolshit*, Iliria 1983, 2, f. 47, tab. I-X.

përdorimit të saj. Në Rudnik III²⁴, del nga përdorimi pikturimi i bardhë, ndërsa në qeramikën fine të pikturuar me ngjyrë kafe mbi sfond të kuq, krahas motiveve lineare shfaqen për të parën herë edhe ato spirallike e kurbolineare²⁵. (tab. I, 2-enë me dekor të pikturuar kafe mbi të kuq me motive spirallike). Një dukuri e ngjashme është konstatuar edhe në Vlashnje I dhe në Kolsh I, gjë që vërteton karakterin e njëkohshëm të këtyre horizonteve kulturore dhe atij Rudnik III. Në skemën e përgjithshme kronologjike të grupit Starçevo, Rudniku III i përgjigjet fazës Starçevo II b.

2. Vlashnje(Prizren)

Vlashnja është vendbanimi i dytë i rëndësishëm i neolitikit të hershëm në pellgun e Drinit të Bardhë, pas atij të Rudnikut. Ai shquhet për një vazhdimësi të gjatë banimi, që nga neoliti i hershëm deri në periudhën e vonë antike²⁶ (fig. 2). Në këtë vendbanim janë kryer 4 fushata gërmimi me karakter shpëtimi²⁷, gjatë të cilave është gërmuar një sipërfaqe e përgjithshme prej 704 m², e kushtëzuar nga rreziku i asgjësimit përfundimtar të depozitimeve kulturore në pjesën më intensive të tyre²⁸ (fig. 3). Nga të dhënat e stratigrafisë vertikale dhe asaj horizontale, rezultojnë se ai është banuar gjatë periudhave të mëposhtme kronologjiko-kulturore:

- Vlashnje I a- neoliti i hershëm i tipit Starçevo IIa.
- Vlashnje I b- neoliti i hershëm i tipit Starçevo IIb.
- Vlashnje II - neolit i mesëm i tipit Vinça-Tordosh I.
- Vlashnje III- neolit i vonë i tipit Vinça-Plloçnik I dhe Danilo-Reshtan.
- Vlashnje IV- eneolit i tipit Bujanj Hum I b.
- Vlashnje V a- periudha e hershme e bronzit.
- Vlashnje V b- periudha e mesme e bronzit
- Vlashnje V c- periudha e vonë e bronzit.
- Vlashnje VI- periudha e hershme e hekurit(shek. XI-VIII)
- Vlashnje VII a- periudha subgjeometrike dhe arkaike(shek. VII-VI para Kr)
- Vlashnje VII b- periudha klasike(shek. V para Kr)
- Vlashnje VIIc- periudha helenistike(shek. IV-I para Kr)
- Vlashnje VIII- periudha antike romake(shek. I-IV pas Kr)
- Vlashnje IX- periudha e vonë antike(shek. V-VI pas Kr).

²⁴ Rudniku III sipas N. N. Tasiçi përket fazave II-III të neolitikit të mesëm ballkano-qëndror, ndërsa Rudniku IV, fazës III a-b të neolitikit të mesëm të këtij rajoni. Shih : N.N. Tasiçi *The Starçevo culture...*f. 51.

²⁵ Në Rudnik, në rrethana jo shumë të qarta stratigrafike, është gjetur edhe një këmbë ritoni i zbuluar me motive të inçizuara gjeometrike dhe të inkrustuar me pastë të bardhë, të tipit Reshtan. Në këtë kontekst është e vështirë që të përcaktohet me siguri pozicioni kronologjik i tij.

²⁶ E. Shukriu-Hoti, *Kërkimet arkeologjike përgjatë...*f. 192-193. Nga gjetje të pakta sipërfaqësore është përfaqësuar edhe periudha e hershme mesjetare(shek. VII-XI pas Kr).

²⁷ Në pjesën juglindore të terracës së vendbanimit në vitin 2008 janë ndërtuar nga pronarët e truallit dy shtëpi 3 katëshe me sipërfaqe të përgjithshme 288m². Shtëpia nr. 1 është vendosur mbi kuadratet V -VIII të sek. C të gërmuar në vitin 2007, ndërsa shtëpia nr. 2 mbi kuadratet IX-XII të këtij sektori, gjithashtu të gërmuar gjatë asaj fushate.

²⁸ Sipërfaqja e gërmuar sipas viteve është: 2002-53m², 2006-233m², 2007-337m² dhe 2008-81m².



Fig. 2. Vlashnje - Foto ajrore e vendbanimit.




Fig. 3. Vlashnje-Planimetria e përgjithshme e gërmimeve 2002 - 2008.

Periodha e neolitit të hershëm në Vlashnje është përfaqësuar nëpërmjet dy fazave të zhvilluara të neolitit të hershëm ballkano-qendror, të emërtuara Vlashnje I a-b, dhe të sinkronizuara me fazat Starçevo II a-b.

Faza Vlashnje I (a-b) përfaqëson një shtresë kulturore mjaft kompakte, me trashësi nga 0.40 m deri në 0.60-0.70m, të kuadratit II të sek. A, kuadr.I-II të sek. B të tarracës jugperëndimore të vendbanimit, si dhe në kuadratet I-V të sek. C të tarracës qendrore të tij. Stratigrafikisht ajo është e vendosur mbi tabanin gjeologjik të vendbanimit dhe mbulohet zakonisht nga depozitimet e neolitit të mesëm të tipit të Vinçës. Ajo formohet nga dy horizonte banimi të vendosur njeri mbi tjetrin, të emërtuar Vlashnje I a dhe I b, përkatësisht të lidhura me fazat Starçevo II a dhe Starçevo II b, stratigrafikisht të fiksuara në kuadratin V të sek. C (fig. 4).

Banesat e fazës Vlashnje I a, kanë dysheme të shtruara me një shtresë të trashë argjilore dhe sipërfaqe të lëmuar me ajkë balte të përzier me hi, të shtruar mbi një platformë gurësh lumorë në trajtë të një kalldrëmi të ngjeshur e të realizuar shumë të bukur. Tiparet kulturore të saj përcaktohen nga qeramika barbotine që mbizotëron, ajo impresso që është më e rrallë si dhe nga qeramika monokrome e kuqe me fakturë të hollë. Në fillimet e këtij horizonti, në thellësinë 1.50m të kuadratit B II (gërmime të vitit 2002) shfaqet dekori i pituruar me ngjyrë të bardhë mbi sfond të kuq, me motive gjeometrike në trajtë rrjete, që zbukurojnë pjesën e sipërme të kupave sferike²⁹. Megjithatë

²⁹ A. Bunguri, *Raport mbi gërmimet e vitit 2002 në Vlashnje*, Arkivi i Institutit Arkeologjik, Tiranë, Muzeu i Kosovës, Prishtinë.

Vlashnje 2007 - Profili lindor i kuadrantit C-V




Fig. 4. Vlashnje- Profili lindor i kuadr. V sek. C (2007).

aktualisht kjo teknikë dekorative është përfaqësuar vetëm nga një fragment, dukuri e njohur më parë edhe në Kolsh I³⁰, ai mjafton për ta sinkronizuar këtë fazë të zhvillimit neolitik të Vlashnjës me fazën Starçevo II a-Rudnik II, Anzabegovo-Vrocnik I c, atë Vashtëmi-Podgori Ia-b³¹, si dhe me fazën protosesklo të Thesalisë³², dhe atë të Nea Nikomedeias³³ kur shfaqet kjo teknikë dekorative. Gjithashtu ai vlen për të menduar se rrugëpërhapja e kësaj teknike dekorative nga pellgu i Korçës në pellgun e dy Drinave (Kolsh) dhe Drinit të Bardhë (Vlashnje) duhet të jetë kryer nëpërmjet luginës së Drinit të Zi. Pikturimi me bojë të bardhë mbi sfond të kuq, që shfaqet në fazën Rudnik II, për t'u zhdukur në atë Rudnik III, është një dukuri e konstatuar më parë në fazën Starçevo II a, për të dalë nga përdorimi në atë Starçevo II b.

Në horizontin e parë Vlashnje I a, në të dy kategoritë e qeramikës, janë të pëlqyera format sferike të enëve. Në qeramikën me fakturë të trashë, ndeshen këto forma kryesore:

1. Enë me trup të fryrë sferik, pa qafë, me buzë të drejta ose të anuara lehtë nga brenda të zbukuruara me barbotin fshesor me relief të ulët, që fillon menjëherë nga buza (tab. II, 1-2). Enë të këtij tipi gjenden edhe në shtresën e neolitit të hershëm Kolsh I³⁴ (Kukës), Vashtëmi-Podgori I³⁵ (Korçë), Rajcë³⁶ dhe Rashtan³⁷ (Prrenjas),

³⁰ M. Korkuti, *Vendbanimi neolitik i Kolshit*, Iliria 1983, 2, f. 29.

³¹ F. Prendi, *Neoliti dhe eneoliti në Shqipëri*, Iliria VI, 1976, f. 24, tab. II, 1-6; M. Korkuti, *Neolithikum und Chalkolithikum in Albanien*, Mainz am Rhein, 1995, f. 37, tab. VI, 1-10.

³² Po aty, f. 26; V. Milojević, *Ergebnisse der Deutschen Ausgrabungen in Thessalien (1953-1958)*, "Jahrbuch des Römische-Germanischen Zentralmuseums", Mainz, 6, 1059, tab. VI, 8, IX, 7.

³³ F. Prendi, vep. cit., f. 25; R. J. Rodden, *Excavations at the Early Neolithic Site at Nea Nikomedia, Greek Macedonia*, (1961 season), "Proceedings of the Prehistoric Society", 28, 1962, f. 281 e vv, fig. 9-10.

³⁴ M. Korkuti, *Vendbanimi neolitik i Kolshit...* f.26-27, tab. IV, 2-3.

³⁵ M. Korkuti, *Vashtëmia...* f.101, tab. V, 9-14.

³⁶ I. Gjipali, *Vendbanimi neolitik i Rajcës (Rajcë I)*, Iliria 1997, 1-2, tab. II, 14-15.

³⁷ Po ai, *Vendbanimi neolitik i Rashtanit (Librazhd)*, Iliria 1995, 1-2, tab. IV, 1.

në vendbanimin e neolitit të hershëm Zlastrana (Ohër)³⁸ etj si dhe në zonën adriatikase të neolitit të hershëm të Dalmacisë (Smilçiç I, Zelena peçina, Jami na Sredi etj)³⁹.

2. Enë me trup të fryrë sferik, qafë të shkurtër cilindrike ose konike dhe buzë të drejta ose të anuara nga jashtë. Zbukurohen rrallë me impreso thoi (tab. II, 3-4). Enë të ngjashme gjenden në Kolsh I⁴⁰, Rashtan⁴¹ (Prenjas) etj, në vendbanimin e neolitit të hershëm Zlastrana⁴² (Ohër), në Obre I të Bosnjës(faza protokakanj)⁴³ etj.

3. Tasa trungkonikë (tab. II, 5-8). Zbukurohen me barbotin të kanelyruar ose fshesor me relief të ulët dhe në ndonjë rast edhe me gropëzime gishti në buzë (tab. II, 8). Forma identike enësh gjenden në Kolsh I⁴⁴, Burim I⁴⁵, Rajcë⁴⁶ dhe Rashtan⁴⁷(Prenjas) etj. Tasa të tillë janë shumë të ngjashëm me tasat e fazës I-II të kulturës Starçevo – impreso në Obre I⁴⁸, me ato të vetë Starçevos, ku gjithshu zbukurohen me barbotin të kanelyruar⁴⁹, si dhe me ato të zonës adriatikase të neolitit të hershëm(Smilçiç I)⁵⁰.

4. Enë sferike me qafë të lakuar(tab. II, 9-10) që ndeshen në të dy kategoritë e qeramikës, të njohura gjithashtu edhe nga poçeria e vendbanimeve të tjera neolitike etj.

Në qeramikën e hollë monokrome të kuqe të horizontit të dytë, Vlashnje I b, mbizotërojnë kupat sferike ose gjysëm sferike (tab. III, 1-3, XVI, 1-2). Në këtë kategori të poçerisë, vihet re edhe prirja drejt bikonizimit të trupit (tab. III, 4), gjë që është karakteristike e fazës fundore të neolitit të hershëm. Enët mbështeteshin mbi funde me këmbë të ulët apo më të lartë unazore(tab. III, 5-7). Një pjesë e tyre janë të zbukuruara me pikturim kafe mbi sfond të kuq, me motive linearo-geometrike, të një stili të pjekur të tipit Starçevo IIb (tab. III, 2-4, XVI, 3-8). Kjo teknikë dekorative shfaqet në këtë periudhë dhe e vë në lidhje qeramikën e pikturuar të Vlashnjës I b me atë të Rudnikut II-III, Kolshit I⁵¹ dhe Starçevo II b.

Jeta shpirtërore është relativisht mirë e përfaqësuar nëpërmjet tavolinave ose altarëve të kultit me 4 këmbë, zakonisht të zbukuruara me inçizim të thellë gjeometrik (tab. III, 8), të ngjashme me ato të Kolshit I të grupit kulturor Starçevo II a-b. Elementët e mësipërm morfologjik

³⁸ Ī. Kóçmaĭ, *Çëcàòπαĭa-ĭeoëèðcka ĭaceëÛa bo Oòpèäcko*, Macedonia acta archaeologica, 11, 1987-1989, Ńkoiĭe 1990, f. 39; tab. III, 5.

³⁹ S. Batoviç, *Neolitsko nalažiste u Smilçiçu*, Diadora 2, 1960-1961, Zadar 1962, fig. 6, nr. 1-2, Praistorija II, tab. LXXVIII, 4, LXXXV, 2, LXXX, 9.

⁴⁰ M. Korkuti, *Vendbanimi neolitik*, tab. IV, 1, 4.

⁴¹ I. Gjipali, *Vendbanimi neolitik*, tab. IV, 2-6.

⁴² Ī. Kóçmaĭ, *Çëcàòπαĭa-ĭeoëèðcka ĭaceëÛa bo Oòpèäcko*, Macedonia acta archaeologica, 11, 1987-1989, Ńkoiĭe 1990, f. 39; tab. III, 1-4.

⁴³ A. Benac, *Prelazna Zona*, Praistorija...II...tab. LVII, 2.

⁴⁴ M. Korkuti, *Vendbanimi neolitik*, tab. IV, 8.

⁴⁵ A. Bunguri, *Qytetërimet prehistorike në rajonin e Dibrës* (në shtyp), Tiranë 2010, tab. V, 6.

⁴⁶ I. Gjipali, *Vendbanimi neolitik*, f. 32, tab. III, 11.

⁴⁷ Po ai, *Vendbanimi neolitik*, tab. V, 4, 6, 7.

⁴⁸ M. Garaceanin, *Centralnobalkanska zona*, Praistorija...II, tab. LIII, 4; LVI, 2.

⁴⁹ Po aty, tab. XVIII, 1.

⁵⁰ B. Coviæ, *Jadranska Zona*, Praistorija II, tab. LXXVIII, 1, 6.

⁵¹ M. Korkuti, *Vendbanimi neolitik*, tab. III, 1-10.

dhe stilistik e dekorativ e përfshijnë shtresën Vlashnje I a-b në fazat II a-b të grupit kulturor Starçevo të Ballkanit qëndror, qoftë dhe si një variant periferik juglindor të saj.

3. Glladnicë

Vendbanimi gjendet pranë fshatit Graçanicë, në afërsi të Prishtinës. Gërmimet e sondazhit të vitit 1956, u pasuan nga gërmimet sistematike të vitit 1959, të drejtuara nga J. Glisicë. Sipërfaqja e gërmuar arrin mbi 300m², ndërsa trashësia e depozitimeve 2.50-3.00m⁵². Nga vlerësimi stratigrafiko-kulturor i tyre, rezulton prania e dy shtresave kulturore, Glladnicë Ia dhe Ib, të lidhura me dy faza të neolitikit të hershëm ballkanoqëndror, atë Starçevo II b dhe Starçevo III, si dhe e një gropë depozitë, që i takon fundit të eneolitikit dhe fillimit të bronzit të hershëm, të emërtuar Glladnicë II. Në shtresën më të poshtme Glladnicë Ia është gjetur qeramikë barbotine, impreso dhe monokrome të kuqe së bashku me qeramikë të pikturuar me ngjyrë kafe mbi sfond të kuq, me motive lineare⁵³, që e datojnë atë në fazën Starçevo II b të neolitikit të hershëm ballkano-qëndror dhe e paralelizojnë me fazën Zhitkovac I, ndoshta me një përparësi të lehtë kronologjike të Glladnicës Ia.

4. Zhitkovac I

Vendbanimi gjendet në tarracën lumore në krahun e djathtë të lumit Ibër, pranë fshatit eponym, në afërsi të Mitrovicës. Ai është vendosur rreth 2 km më në veri të vendbanimit më të vonë neolitik të Valaçit. Vendbanimi u zbulua gjatë hapjes së trasesë hekurudhore për në Mitrovicë në vitin 1955, ndërsa në vitin 1958 u kryen aty gërmime kontrolli nga N. Tasië në një trench me përmasa 12x4m⁵⁴. Nga gërmimet rezultoi se në këtë vendbanim neolitik ishin përfaqësuar dy shtresa kulturore të zhvillimit të tij, të emërtuara Zhitkovac I dhe II, kjo e fundit e zbuluar në një gropë depozitë, përkatësisht të lidhura me neolitikin e hershëm të fazës Starçevo II b dhe atë të mesëm të fazës Vinça-Tordosh I⁵⁵.

Kultura e fazës më të hershme Zhitkovac I përbëhet kryesisht nga fragmentet e enëve dhe karakterizohet nga qeramika monokrome e kuqe, qeramika e pikturuar me ngjyrë kafe mbi sfond të kuq, qeramika me dekor të lëmuar (glaëanje)⁵⁶ dhe qeramika

⁵² J. Glisicë - B. Jovanovicë, *Praistorisko naselje na Gladnicama kod Graçanice, Sondažno Rezagosciranje 1956*, GMKM, II, Pristina 1957, f. 223-233, tab. I-V ; N. N. Tasië *The Starçevo Culture*, "ATKM, from the Neolithic to the Early Middle Ages, Beograd 1998, f. 45.

⁵³ M. Garacëanin, *Centralnobalkanska zona, Starëvevaëka grupa*, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja II, Sarajevo 1979, f. 136.

⁵⁴ N. Tasië, *Žitkovac i neki problemi relativnog hronološkog...*, f. 12; Po ai, *Introduction to the prehistory, antiquity and early Middle Ages in Kosovo and Metohija*, Arheoloëko Blago Kosova i Metohije od neolita do ranog credneg veka, Beograd 1998, f. 23; N. N. Tasië *The Starçevo Culture*, "ATKM, from the Neolithic to the Early Middle Ages, Beograd 1998, f. 39.

⁵⁵ Gjithashtu në nivelet e sipërme të shtresës kulturore të vendbanimit të Zhitkovacit është zbuluar dhe një shtresë e hollë e bronzit të hershëm, e emërtuar Zhitkovac III, me elementë të qartë të kësaj periudhe, ku do të përmendnim filxhanat trungkonikë me një vegjë shiritore mbi buzë, të punuar me qeramikë gri të errtë ose të kuqërremtë, të ngjashëm me ato të Maliq III a. Shih: F. Prendi-A. Bunguri, *Bronzi i hershëm në Shqipëri*, Prishtinë 2008, f. 82, tab. XI, 9-10.

⁵⁶ N. Tasië, *Žitkovac i neki problemi relativnog hronološkog...*, f. 15.

barbotine, kjo e fundit shpesh e shoqëruar dhe me shirita plastikë horizontale të impresuar mbi supe. Shirita të tillë zakonisht shërbejnë si kufizues midis pjesës së poshtme të barbotinuar të enës dhe asaj të sipërme të rrafshhtë. Ngjyra e qeramikës së barbotinuar është zakonisht e kuqe tulle. Ka barbotin me sprucim të lehtë dhe të organizuar me viaska të cekta apo të dukshme. Format më të zakonshme të enëve janë ato me trup të rrumbullakuar, ndërsa enët konike me këmbë të lartë trungkonike të tipit të frutierave ndeshen më rrallë. Qerammika barbotine me hollësiat teknike të punimit, me ngjyrën e saj të kuqe tulle dhe me stile të saj dekorative, e afron shumë këtë kulturë të tipit Starçevo II b me atë të Kolshit I (Kukës), të Rashtanit dhe Rajcës (Prenjas) dhe deri me atë të vendbanimeve të hershme neolitike të Vashtëmisë dhe Podgorisë I (Korçë). Plastika figurale dhe e objekteve të tjerë të kultit, megjithëse të kufizuar në numër, riprodhojnë tipa të njohura të Starçevos. Në bazë të analogjive kulturore, rezulton se kultura e fazës Zhitkovac I si është pjesë e grupit kulturor Starçevo dhe mund të sinkronizohet me fazat Glladnicë I a dhe Starçevo II b.

Faza III e neolitit të hershëm

Aktualisht përfaqësohet më qartë nga faza Rudnik IV dhe ajo Glladnicë Ib. Në këtë fazë në Rudnik vihen re disa ndryshime në elementët e kulturës. Piksëpari, qeramika e kuqe e tipit Starçevo II fillon të zëvendësohet nga qeramika e zezë, me ose pa lustër, e natyrës vinçiake. Në këtë fazë mbizotëron poçeria e vrazhdë, ku shfaqet barbotini i organizuar, si dhe kombinimi i teknikave të ndryshme plastike dekorative. Gjithashtu për të parën herë shfaqen zbukurimet me inçizim, të një stili tipik për kulturën e hershme vinçiake. Me këto elementë morfologjikë e dekorativë mendojmë se faza Rudnik IV duhet lidhur me një etapë kalimtare nga neoliti i hershëm në neolitin e mesëm ballkano-qëndror. Në këtë kontekst ajo gërsheton elementë të grupeve kulturore të neolitit të hershëm dhe atij të mesëm ballkano qëndror (Starçevo III-Vinça I), që në literaturën arkeologjike klasifikohet si neolit i mesëm⁵⁷, pa munguar në këtë kulturë as elementët adriatikas të tipit Danilo –Kakanj⁵⁸ dhe atij thesalian (Sesklo III a)⁵⁹. Faza Glladnicë I b, që i referohet shtresës së sipërme të vendbanimit eponym, karakterizohet nga qeramika barbotine, qeramika e inçizuar dhe mungesa e qeramikës së pikturuar e tipit Starçevo, dukuri e ndeshur edhe në fazën Rudnikun IV, dhe e njohur gjatë fazës Starçevo III edhe në pellgun e Danubit të poshtëm si dhe në grupin Kremikovc të fushës së Sofies⁶⁰.

⁵⁷ M.Garašanin, *Centralnobalkanska zona, Starëvaaka grupa*, PJZ, II, Neolitsko Doba, Sarajevo 1979, f. 126, fig. 11, nr.13, f. 136, tabelë kronologjike, f. 212.

⁵⁸ Në Rudnik, në rrethana jo shumë të qarta stratigrafike, është gjetur edhe një këmbë ritoni i zbukuruar me motive të inçizuara gjeometrike dhe të inkrustuar me pastë të bardhë, të tipit Danilo-Kakanj. Në këtë kontekst është e vështirë të përcaktohet me siguri pozicioni kronologjik i tij. Një fragment ritoni i ngjashëm është gjetur bashkë me qeramikë të tipit impresso cardium në shtresën Blaz II (Mat), që i takon fazës fundore të neolitit të hershëm. Shih: F. Prendi, *Vështrim mbi kulturat neolitike dhe të epokës së bronzit në Shqipëri*, Studime historike 1979, 4, f. 132.

⁵⁹ N. N. Tasiæ, *The Starçevo Culture, ATK and Metohija from the Neolithic to the Early Middle Ages*, Beograd 1998, f.49-53.

⁶⁰ M.Garašanin, *Centralnobalkanska zona, Starëvcka grupa...f. 136.*

2. Periudha e neolitit të mesëm

Në Rrafshin e Dukagjinit vendbanimi më mirë i njohur me kulturë të neolitit të mesëm, është ai i Vlashnjes së Prizrenit (Vlashnje II), dhe nga gjetjet sipërfaqësore edhe ai i Pogrades (Klinë), ndërsa në Rrafshin e Kosovës, vendbanime të tilla, të njohura stratigrafikisht janë Tjerrtorja I a-b (Prishtinë), Fafosi I a-b dhe Zhitkovaci II (Mitrovicë), Në pikëpamje topografike janë përfaqësuar dy tipe vendbanimesh, si ata të vendosura në fusha aluvionale (Tjerrtores, Fafos, Zhitkovac) ashtu edhe ata të vendosura në terraca lumore me mbrojtje natyrore (Vlashnje, Pogradec).

Në pikëpamje kronologjiko-kulturore, kultura e neolitit të mesëm në territorin e Kosovës, përputhet me fazat Vinça-Tordosh I-II të Ballkanit qëndror. Gjatë kësaj periudhe e gjithë hapësira e saj mbulohet nga kultura e hershme vinçiake, e cila është verifikuar stratigrafikisht në vendbanimet e mëposhtme:

1. Vlashnje II

Shtresa kulturore e neolitit të mesëm është fiksuar në kuadratet I-IV të sektorit B, në kuadratin V të sektorit C të anës jugperëndimore etj. Stratigrafikisht ajo është vendosur mbi atë Vlashnje I b të neolitit të hershëm dhe arrin trashësinë 0.40-0.60m.(fig. 4). Lënda kryesore përbëhet si zakonisht nga qeramika, e cila ndryshon tërësisht nga ajo e neolitit të hershëm. Karakteristike për këtë periudhë është qeramika gri e zezë dhe e zezë, me fakturë mesatare dhe të hollë, me lëmim të mirë apo me lustër të zezë me shkëlqim. Në këtë periudhë pasurohet dukshëm repertori i enëve dhe shfaqen teknika të reja dekorative. Ndër format me kryesore përmendim enët bikonike me buzë të kthyera lehtë nga jashtë (tab. IV, 1-3), enët bikonike me qafë cilindrike dhe vegjë në trajtë briri (tab. IV, 5), enët sferike me grykë të mbledhur nga brenda (tab. IV, 4) ose me qafë të lakuar (tab. IV, 6), kupat dykonike të zbukuruara me thimtha plastike në vijën e karenimit (tab. IV, 7-10), kupat me profil S-je (tab. IV, 11-12) etj. Në teknikat e reja dekorative, vendin kryesor e zënë brezat e inçizuar të mbushur me shpime të stilit të hershëm vinçiak (tab. IV, 1-4, V, 1-5), dhe në ndonjë rast të kombinuar edhe me thimtha plastike në supe (tab. IV, 1), thimthat plastike cilindrike ose eliptike, që paraqiten të vendosura një nga një ose në çifte përkundruall (tab. IV, 2, 7, 8-9), si edhe në trajtë brezash horizontale të mbushur me thimtha cilindrike (tab. V, 11) apo thimtha eliptike në trajtë brinjësh vertikale (tab. V, 9), inçizimet me vija të thelluara me motive linearo-geometrike të vijëzuara në mënyrë alternative (tab. V, 6-8, 10), dhe shumë rrallë edhe kurboleare (tab. V, 12) etj. Forma enësh të ngjashme, të zbukuruara me ornamente plastike të gjetura në Pogradec, e përfshijnë këtë vendbanim në të njëjtën fazë zhvillimi me atë të Vlashnjës II a. Format e mësipërme të enëve dhe teknikat dekorative të tyre, të kujtojnë format klasike të fazës Vinça-Tordosh I- II të neolitit të mesëm ballkano-qëndror⁶¹, dhe më saktë i variantit kosovar të kulturës Vinça⁶², me të cilin duket qartë se Vlashnja II a dhe Pogradec I përputhen në treguesit e tyre më kryesorë.

⁶¹ Po aty, f. 168, 170, fig. 12, nr. 1-4, 8-12.

⁶² M. Garaceanin, *Centralnobalkanska zona, Juznamoravska i Kosovska Varijanta Vinçanska grupa*, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja II, Sarajevo 1979, f. 189-190, tab. XXVIII, 4, 5.

2. Tjerrtores (Predionicë I-a-b)

Vendbanimi i Tjerrtores njihet në literaturë me emrin Predionicë. Është ndër vendbanimet e para neolitike të zbuluara në Kosovë, gjatë punimeve për ndërtimin e fabrikës së tjerrtores së pambukut, në vitet 1949-1951, në fshatin Predionicë, afër Prishtinës (1949-1951). Është gërmuar në vitet 1950-1951 dhe 1955-1956 nga R. Galovia⁶³. Në pikëpamje stratigrafiko-kulturore ndahet në dy periudha kronologjike, Predionicë Ia-b dhe II, të lidhura përkatësisht me ato Vinça-Tordosh I-II dhe Vinça-Pllloçnik I të variantit moravo-jugor kosovar të kulturës Vinça⁶⁴.

3. Fafos I a-b

Vendbanimi gjendet pranë lumit Sitnicë afër Mitrovicës, në vendin ku është ndërtuar fabrika e industrisë kimike e përpunimit të fosfatit, prej të cilës ka marrë edhe emrin. Është gërmuar në vitet 1957-1958⁶⁵. Zhvillimi kulturor i këtij vendbanimi ka ndjekur tri faza kronologjike, të përcaktuara si Fafos Ia, Fafos Ib dhe Fafos II. Në Fafos I a janë gjetur mjaft vegla pune prej guri, kocke dhe briuri. Qeramika e fazës më të hershme Fafos I a i korrespondon në përgjithësi fazës Vinça-Tordosh I, pavarësisht nga veçoritë lokale.

Banesat e fazës Fafos I a ishin kasolle mbitokësore, të ndërtuara me shtylla druri e thurje thuprash të lyera me baltë, me planimetri drejtkëndëshe. Qeramika kësaj faze zakonisht është gri e errët ose e zezë. Si nga format dhe dekori ajo riprodhon ato të qeramikës së hershme vinçiake. Dekori është bërë me inçizim në formë shiritash të gropëzuar, shpesh i inkrustuar me pastë të kuqe që fshihet. Format mbizotëruese janë kryesisht bikonike, ndeshen dhe vazot me vegjë antropomorfe. Midis materialit të Fafosit I b të tërheqin vëmendjen disa fragmente qeramike *black-topped*, që të kujton atë të kupave të kulturës Maliq I-Kamnik me ngjyrë kuq e zi, analogji të vlefshme edhe për një sinkronizim të fazës Fafos I b me atë Maliq I-Kamnik. Në Fafos I b janë gjetur edhe disa tavolina kulturi, figurina balte të sferës së jetës shpirtërore si dhe kapakë prozomorfikë.

4. Zhitkovac II

Fazës Vinça-Tordosh I do t'i korrespondonte edhe shtresa Zhitkovac II, e konstatuar në lokalitetin Karagaç të Zhitkovacit dhe në breg të lumit Lushtë në periferinë e Mitrovicës, që mund të sinkronizohet me Fafos I a.

⁶³ R. Galovia, *Predionica, Neolitsko Naselje kod Prishtine*, Muzej Kosova i Metohije, Prishtina 1959, f. 37-38 (resume shqip).

⁶⁴ M. Garaceanin, *Centralnobalkanska zona, Vinçanska grupa*, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja II, Sarajevo 1979, f. 190.

⁶⁵ Arkivi i Muzeut të Kosovës.

3. Periudha e neolitit të vonë

Në pikëpamje kronologjike, kultura e kësaj periudhe i korrespondon fazës më të re Vinça-Ploçnik I të kulturës së Vinçës dhe i takon fillimeve të neolitit të vonë. Në Rrafshin e Kosovës kultura e neolitit të vonë njihet nga shtresa Tjerrtore II dhe Bardhoshi (Prishtinë), Fafosi II dhe Vallaçi (Mitrovicë) Gërçari (Viti), Barileva (Podujevë) etj, që përfshihen në variantin kosovar të zhvilluar të kulturës së Vinçës⁶⁶. Në Rrafshin e Dukagjinit ajo njihet stratigrafikisht në mënyrë më të plotë në vendbanimin e Reshtanit, në shtresën më të hershme Hisar I (Suharekë) si dhe në shtresën Vlashnje III (Prizren), ku komponentja vinçiake bashkëjeton me atë danilike të vonë. Gjatë këaj faze të hershme të neolitit të vonë shënohet ekspansioni më i madh i kulturës Danilo në drejtim të brendësisë kontinentale ballkanike, duke përfshirë brenda sferës periferike të saj të gjithë Rrafshin e Dukagjinit, ndërsa elementë të saj, siç janë motivet e inçizuara adriatikase, depërtojnë deri në Rrafshin e Kosovës (Tjertore II)⁶⁷. Më poshtë do të japim përmbledhtazi tiparet e vendbanimeve më përfaqësuese.

1. Reshtan

Vendbanimi i Reshtanit gjendet në një fushë të sheshtë aluvionale në krahun e djathtë të lumit Topluga, në fshatin eponym, afër Suharekës. Gërmimet e para me karakter sondazhi janë bërë në vitin 1963 nga J. Todoroviæ, ndërsa gërmimet sistematike në vitet 1967-1967 nga J. Glicicæ⁶⁸. Shtresa kulturore me trashësi rreth 2 m i takon fazës së vonë të neolitit të mesëm, me elementë të përzier të tipit vinçiak dhe adriatik⁶⁹. Nga gërmimet rezulton se kanë qenë në përdorim si banesat gjysëm të nëndheshme ashtu dhe ato mbitokësore. Banesat kanë qenë kasolle me skelet druri, me formë katërkëndëshe, ndonjëherë edhe me planimetri dykthëshë, me mure të ndërtuara prej gardhi thuprash të lyera me baltë. Nga gërmimet janë zbuluar edhe gjurmë të furrave të pjekjes që kanë qenë vendosur në hapësirën e jashtme të banesave. Pjesa dërmuese e materialit të lëvizshëm arkeologjik përbëhet nga fragmentet e qeramikës. Veglat prej guri, stralli dhe kocke janë mjaft të rralla dhe ruajnë tiparet e përgjithshme të epokës neolitike⁷⁰. Në pikëpamje teknologjike janë përfaqësuar dy kategoritë kryesore të qeramikës, ajo me fakturë mesatare e të hollë, që mbizotëron, dhe ajo me fakturë të trashë. Në kategorinë e parë vihen re dy lloje krejt të ndryshme midis tyre, qeramika e tipit ballkano-qëndror, e përfaqësuar nga qeramika me fakturë mesatare me ngjyrë gri të zezë ose të zezë me lustër, që përbën tiparin kryesor për kulturën e

⁶⁶ M. Garašanin, *Centralnobalkanska zona, Vinčanska grupa...* f. 190.

⁶⁷ R. Galoviæ, *Neolitsko Naselje Kod Prištine*, Muzej Kosova i Metohije, Priština 1959, f. 38, tab. 9, 3-4; 62, 1-5; 63, 1-6; 71, 1; 75, 1.

⁶⁸ Arkivi i Muzeut të Kosovës.

⁶⁹ A. Benac, *Prelazna Zona, Juzna Metohija*, PJZ, II, Sarajevo 1979, f. 457-459, tab. LXVIII, 1-9, LXIX, 1-8.

⁷⁰ Po aty, f. 458.

Vinçës dhe ajo e tipit adriatik, me parete të holla, që dallon për cilësinë e mirë të punimit, për tonet e ndryshme të ngjyrës së sipërfaqes së enës, për format më të zhvilluara dhe sistemin më të pasur ornamental. Fizionomia e kulturës përcaktohet nga qeramika me fakturë mesatare dhe ngjyrë gri të errët dhe të zezë si dhe qeramika e hollë me lustër të zezë me shkëlqim. Enët e tipit vinçiak kanë kryesisht formë trungkonike dhe bikonike, por zbukurimet e tyre, përfshirë dhe kanelyrat, janë më të thjeshta se ato të kulturës tipike vinçiake. Në enët e tipit adriatik bien në sy ato me trup sferik e gjysëm sferik, enët me këmbë në formë këmbane, kupat me profil në trajtë S-je si dhe vazot me qafë të shkurtër apo më të gjatë cilindrike. Zbukurimet kryesore të këtij grupi enësh janë ato me inçizim, me alternimin e motiveve gjeometriko-lineare me atyre kurbo-lineare, por pa aritur tek ai spiraloid, si një prej veçorive thelbësore të grupit Danilo, gjë që do të thotë se në Reshtan nuk kemi motive të mirëfillta të kësaj kulture. Motivet më të pëlqyera gjeometriko-lineare janë rrjeshtat me trekëndësja dhe rombe të vijëzuar, shiritat e vijëzuar vertikale, motivet e tipit fushë shahu apo në formë rezesh, tufat e vijave vertikale të kryqëzuara etj (tab. VII, 1-6). Qeramika e inçizuar e Reshtanit është e ngjashme me atë të Kolshit II (Kukës)⁷¹, të Topopjanit II (Dibër)⁷², Cakran-Dunavecit II (Shqipëri Jugore)⁷³, të Burimit të Drinit të Zi (Ustie na Drim) në Strugë dhe Mala Trnska tumba (Pelagoni)⁷⁴. Në Reshtan ndeshet edhe ljerja e hapësirës midis motiveve të inçizuara ose sipërfaqeve të zbukuruar me një bojë të zezë që fshihet (tab. VII, 1-2), dhe si një shfaqje e rrallë edhe inkrustimi me pastë të bardhë i motiveve të inçizuara (tab. VII, 1, 5, 6), dukuri e ndeshur edhe në Vlashnje III, Topojan II, Ustie na Drim (Strugë) dhe Mala Trnska tumba (Pelagoni). Karakteristike për këtë kulturë janë ritonet e kultit me 4 këmbë, pa ornamente, që përbëjnë një veçori thelbësore të kompleksit adriatik Danilo-Kakanj⁷⁵, të njohura gjithashtu në Topojan II dhe në një ekzemplar edhe në Mala Trnska tumba (Pelagoni)⁷⁶. Me këto tipare kultura e Reshtanit lidhet ngushtë me fazën e vonë të grupit kulturor Danilo dhe përfshihet në zonën e brendshme periferike të këtij kompleksi, gjë që

⁷¹ M. Korkuti, *Vendbanimi...*, tab. LXIX, 2-3

⁷² A. Bunguri, *Vendbanimi neolitik i Topopjanit*, Iliria 1993, 1-2, tab. XVIII.

⁷³ M. Korkuti-Zh. Andrea, *Stacioni i neolitit të mesëm në Cakran të Fierit*, Iliria III, 1974, tab. XIX., 1-7; M. Korkuti, *Neolithikum und Chalkolithikum in Albanien*, Mainz am Rhein, 1995, tab. XLI, 1, 4-5; tab. LI, 12-15.

⁷⁴ B. Caieã, *Í eoëëðoã è teoëëðñëèðe Kóëðópè ào Makeäoìèja*, ÖÈÀÈÈÈÇAÖÈÈ ÇA ÌO×BATAHA MAKEÄOHÈJA, SCKOÏJE 1995, f. 45.

⁷⁵ *Po aty*, f. 459, tab. LXVIII, 6. Një fragment ritoni i ngjashëm është gjetur bashkë me qeramikë të tipit impresso cardiacum në shtresën Blaz II (Mat), që i takon neolitit të hershëm (Starçevo II b) Shih: F. Prendi, *Vështrim mbi kulturat neolitike dhe të epokës së bronzit në Shqipëri*, Studime historike 1979, 4, f. 132.

⁷⁶ P. Slavicea, *Kult Rhytone der Neolithischen Viehzüchter der Balkanhalbinsel*, Starinar 1966, nr. 47, f. 21-66; D. Simoska-V. Sanev, *Neolitsko naselba na Mala Tumba kaj Selo Trn, Bitola*, Macedonia, Acta Archaologica, Prilep 3, 1977.

kushtëzohet nga vetë pozicioni gjeografik i këtij vendbanimi. Krahas këtyre elementëve, në përbërjen e kësaj kulture, vihen re edhe disa elementë të kulturës Vinça, çka dëshmon për karakterin kompozitë të kulturës së Reshtanit, gjë që është e natyrshme të rezultojë nisur nga pozicioni i gjeografik ndërmjetëm i Reshtanit midis këtyre dy grupeve kulturore të njëkohshëm. Sipas studiuesëve, Reshtani përfaqëson një etapë relativisht të vonshme të kulturës Danilo⁷⁷ dhe mund të sinkronizohet me fazat Danilo III-Hvar I⁷⁸, që përputhet pjesërisht me atë Lisiçic I të neolitikit të vonë dalmatin⁷⁹. Në pikëpamje kronologjiko-kulturore Reshtani është shumë i ngjashëm me vendbanimin Mala Trnska tumba (Pelagoni), ku gjithashtu depërtojnë ornamentet e inçizuara tipike adriatikase, inkrustimi i bardhë i tyre, si dhe ritonet e tipit adriatik.

2. Vlashnje III.

Shtresa kulturore, që i referohet kësaj faze me trashësi 0.20-0.30m, stratigrafikisht është e mbivendosur mbi atë të fazës Vlashnje II, me të cilën ndahet nga një dyshe me argjilore me formë eliptike. Edhe për këtë fazë elementi më karakteristik i kulturës është qeramika gri e zezë dhe e zezë, me fakturë mesatare dhe të hollë, me lëmim të mirë dhe një pjesë edhe me lustër të zezë me shkëlqim. Format kryesore të enëve mbeten ato sferike dhe bikonike (tab. VI, 1, 3, 4), tani të pasuruara edhe forma të reja si të zbuluar me teknike të reja dekorative. Kështu në këtë shtresë shfaqen për të parën herë kupat gjysëm-sferike me buzë të sheshta (tab. VI, 2) si dhe motive të reja dekorative të sferës adriatikase. Është fjala për praninë e elementëve adriatikas të përfaqësuar nga motive të zbuluar me gërvishtje me motivin e rjetës (tab. VI, 1, 2-10) dhe ai spiralik (tab. VI, 11), krahas brezave të inçizuar të stilit më të hershëm vinçiakë (tab. VI, 12-13). Qeramika e inçizuar e Vlashnjës III ngjashmëritë më të mëdha i shënon me qeramikën e inçizuar Reshtanit (Suharekë)⁸⁰, të Kolshit II (Kukës)⁸¹, të Topopjanit II (Dibër)⁸², të Burimit të Drinit të Zi (Ustie na Drim) në Strugë⁸³ dhe Mala Trnska tumba (Pelagoni)⁸⁴, me të cilët Vlashnja formon një grup të veçantë kulturor brenda zonës kalimtare nga Adriatiku në Ballkanin qëndror.

⁷⁷ M. Garaceanin, *Praistorija na tlu Srbije*, vol. II, Beograd 1973, f. 154; A. Benac, *Prelazna Zona, Juzna Metohija*, PJZ, II, Sarajevo 1979, f. 459.

⁷⁸ A. Benac, *Prelazna Zona, Juzna Metohija*, PJZ, II, Sarajevo 1979, f. 459.

⁷⁹ S. Batovica, *Jadranska zona*, Praistorija Jugoslivenski Zemlja II, Neolitsko Doba, Sarajevo 1979, tab. XCIX, 3, 8, 11.

⁸⁰ A. Benac, *Prelazna...* tab. LXIX, 2-3.

⁸¹ M. Korkuti, *Vendbanimi...*, tab. LXIX, 2-3

⁸² A. Bunguri, *Vendbanimi neolitik i Topojanit*, Iliria 1993, 1-2, tab. XVIII.

⁸³ B. Caíeã, *Í eoëèðoã è íeoëèðñêèðe Kóèðópè ào Makeäoíèja*, ÒÈÀÈÈÇAÖÈÈ ÇA ÌO×BATAHAMAKEÄOHÈJA, SCKOÏJE 1995, f. 45.

⁸⁴ A. Benac, *Prelazna Zona*, PJZ, II, 1979, f. 464-467, tab. LXXII, 3-6, 7; B. Caíeã, *Í eoëèðoã è íeoëèðñêèðe Kóèðópè ào Makeäoíèja*, ÒÈÀÈÈÇAÖÈÈ ÇA ÌO×BATAHAMAKEÄOHÈJA, SCKOÏJE 1995, f. 42, 44, fig. e f. 43, 3.

Një dukuri e re, mjaft interesante është ajo e inkrustimit me pastë të bardhë me natyrë adriatike e shpimeve të stilit vinçiak, që ndeshet në mjaft ekzemplarë (tab. V, 1, 3-4, XVII, 1-8). Kjo kategori qeramike shënon analogji të plota me qeramikën e inçizuar dhe të inkrustuar me ngjyrë të bardhë të grupit neolitik të vonë të Reshtanit (Suharekë), Cakran-Dunavec II⁸⁵ (Shqipëri e jugut) dhe Topojan II (Dibër), të Burimit të Drinit të Zi (Ustie na Drim) në Strugë⁸⁶, atë të Tërnit pranë Manastirit (Pelagoni)⁸⁷ etj. Jeta shpirtërore është e përfaqësuar nga ritonet (tab. VI, 14) dhe kapakët konikë (tab. VI, 12-13, XVII, 3). Ritonet e Vlashnjës paraqiten të zbukuruar me inçizim gjeometrik dhe janë krejt identik me objektet analoge të grupit Cakran-Dunavec⁸⁸, Danilo-Kakanj⁸⁹ dhe krejt të ngjashëm me ritonet e neolitit të vonë të tipit Topojan II⁹⁰, si dhe me ritonet e të njëjtës periudhë të Smilçicit II⁹¹. Studiuesit kanë vënë në dukje, se ritonet e kultit e luajnë rolin e tyre të vërtetë në ritet fetare vetëm në fazat fillestare të neolitit të vonë⁹². Sipas studiuesve, ritonet duhet të kenë shërbyer si mbajtëse bishtukësh ndriçimi ose lucerna rituale, gjë që do t'i lidhte me kultin e dritës dhe të zjarrit, ose duhet t'i jenë kushtuar kultit të pjellorisë së gjësë së gjallë⁹³.

Kështu, edhe në Vlashnje përsëritet tabloja e zbuluar me parë në Reshtan dhe në Hisar I (Suharekë). Gërshetimi i elementëve kulturorë të sferës danilike dhe asaj vinçiake, është një dukuri e pritshme edhe nga shtrirja e Vlashnjës në zonën kalimtare nga ajo adriatikase në atë ballkano qëndrore. Në pikëpamje kulturore e kronologjike kjo fazë është e njëkohshme me fazën Reshtan dhe atë Danilo III-IV-Hvar I të Adriatikut si dhe me atë Vinça-Ploçnik të Ballkanit qëndror. Komponentja e fortë adriatikase në Vlashnje II b, e konstatuar si e tillë edhe në vendbanimet e njëkohshme gjeografikisht shumë të afërta Kolsh II, Reshtan e Hisar I, dëshmon për një ekspansion të kulturës danilike në brendësi të Ballkanit qëndror. Në këtë fazë kultura Danilo është mbizotëruese në Rrafshin e Dukagjinit, ndërsa elementë të saj depërtojnë edhe në Rrafshin e Kosovës. Është fjala këtu për stilin danilik të dekorit të inçizuar të mbushjes alternative të fushave të inçizuara të ndeshura në vendbanimin e Tjerrtores (Predionicë)⁹⁴, si dhe përdorimin e teknikës së

⁸⁵ M. Korkuti-Zh. Andrea, *Stacioni i neolitit të mesëm në Cakran të Fierit*, Iliria III, 1974, tab. XIX., 1-7; M. Korkuti, *Neolithikum und Chalkolithikum in Albanien*, Mainz am Rhein, 1995, tab. XLI, 1, 4-5; tab. LI, 12-15.

⁸⁶ B. Cañeà, *vep. cit.*, f. 45.

⁸⁷ Po aty, fig. e f. 43, 3.

⁸⁸ M. Korkuti-Zh. Andrea, *Stacioni i neolitit të mesëm në Cakran të Fierit*, Iliria III, 1974, tab. XXII.

⁸⁹ J. Korovec, *Neolitska naseobina u Danilu Bitinju*, Zagreb 1958, tab. XVII-XXI; M. Garačanin, *Centralnobalkanska zona*, PJZ II, Sarajevo 1979, fig. 21, nr. 9, 19.

⁹⁰ A. Bunguri, *Neoliti dhe eneoliti në luginën e mesme të Drinit të Zi (disertacion)*, Tiranë 1992, f. 86, tab. L, 22-25.

⁹¹ A. Benac, *Prelazna zona*, PJZ II, Sarajevo 1979, tab. XCII, 1-2.

⁹² A. Benac – M. Garačanin – D. Srejović, *Sakljuena Razmatranja*, PJZ, II, 1979, f. 654.

⁹³ S. Batovix, *Jadranska zona*, PJZ II, 1979, f. 559-560.

⁹⁴ Krhs. R. Galovix, *Neolitsko Naselje Kod Prietina*, Muzej Kosova i Metohije, Prietina 1959, f.




Fig. 5. Hisar-Foto ajrore e vendbanimit.

Shtresa kulturore e kësaj periudhe, e veçuar për herë të parë nga J. Todoroviæ në gërmimet e vitit 1962, në bazë të të cilave, Hisari përfshihet në grupin kulturor të zonës kalimtare së bashku me Reshtanin⁹⁶. Kjo shtresë kulturore u fiksua gjithashtu edhe nga gërmimet e vitit 2004 në një sondash me sipërfaqe të kufizuar (2x2m). Ajo kishte trashësi 0.20-0.25 m dhe stratigrafikisht mbulohej nga depozitimet e trasha të shtresës së hershme eneolitike të tipit Bubqanj-Hum I a⁹⁷. Lënda arkeologjike përbëhet kryesisht nga qeramika gri dhe gri e zezë me lustër, me forma që prirën nga bikonizmi, të zbkuruara me motive të inçizuara gjeometrike, tipike adriatikase. Sistemi ornamental përfaqësohet nga rrjeshta trekëndëshash dybrinjënjishëm me fushë të vijëzuar, shirita

inkrustimit me bojë të bardhë dhe të kuqe që fshihet, të konstatuar në disa ekzemplarë në kulturën e këtij vendbanimi⁹⁵. Kjo dukuri e përfshin Rrafshin e Dukagjinit dhe në një farë mase edhe Rrafshin e Kosovës në zonën e veprimit të kulturës së zhvilluar Danilo krahas asaj vinçiake të vonë gjatë kësaj faze të hershme të neolitit të vonë.

3. Hisar I.

Vendbanimi prehistorik i Hisarit gjendet në tarracën më të hershme lumore të Toplugës, midis Suharekës në veri dhe Shirokës në jug, në krahun e majtë të rrugës Prizren-Suharekë. Tarraca në trajtën e një tavoline trungkonike bie me shpatë të pjerrta në tri anë, përveç asaj lindore, ku me anën e një qafe ë lehtë, realizohet komunikimi me zonën përreth (fig. 5 - 6).

38, tab. 9, 3-4; 62, 1-5; 63, 1-6; 71, 1; 75, 1 dhe A. Benac, *Obre II, Neolitsko naselje butmirske grupe na Gornjem polju*, Glasnik Zemaljskog Muzeja Bosne i Hercegovine u Sarajevu, Archaeologija, Novaja Serija, Sveska XXVI, Sarajevo 1971, f. 130-131, tab. LII, 1, 4-8, 10, LIII, 5, 7, 8, 13. LIV, 1, 5, LV, 1-5 etj.

⁹⁵ R. Galoviæ, *Neolitsko Naselje Kod Priæatine*, Muzej Kosova i Metohije, Priæatina 1959, f. 38.

⁹⁶ J. Todoroviæ, *vep. cit.* 1962, f. 31-37, tab. III; A. Benac, *Prelazna Zona, Juzna Metohija*, PJZ, II, f. 460.

⁹⁷ A. Bunguri-Sh. Gashi, *Të dhëna të reja mbi kronologjinë e Hisarit*, Kosova Arkeologjike, 1, Prishtinë 2006, f. 14.

Hisar - Planimetria e pergjithshme e germimeve




Fig. 6. Hisar- Planimetria e përgjithshme e gërmimeve.

me tufa vijash zigzake, shirita të vijëzuar në mënyrë alternative etj (tab. VIII, 1-9). Forma e enëve dhe zbukurimi janë të ngjashme me ato të Reshtanit në veçanti dhe të grupit kulturor të Danilos së vonë në përgjithësi. Me këto elementë Hisari I duhet të përfshihet në kulturën e grupit adriatiko-lindor të fillimeve të neolitit të vonë të fazës Danilo III-IV dhe Hvar I –Lisiçiç, që në këtë kohë shtrihet në të gjithë Rrafshin e Dukagjinit, ndërsa elementë të tij arrijnë edhe në Rrafshin e Kosovës, ku bashkëjetojnë me elementë të Vinçës së vonë. Në pikpamje stratigrafike dhe kronologjiko- kulturore, Hisari I paraprin atë të shtresës Bubanj I a si dhe është pak më i hershëm se sa Tjerrtores II, Valaçi, Fafosi II, Bardhoshi dhe Barileva.

4. Tjerrtores (Predionicë II)

Qeramika e fazës II është punuar me të njëjtën teknikë si edhe në Vinça-Ploçnik I. Format me përdorim më të gjërë e enëve janë ato bikonike dhe konike, tasat e vegjël të tipit Ploçnik etj. Ndeshen dendur fundet e larta e të zbrazëta të kupës me pedestal që i përgjigjen trajtave të ndryshme të Vinçës së vonë. Vegjët janë shiritore, në trajtë lythi, pulle dhe briiri, tipe të njohura në Vinçë dhe në Ploçnik. Zbukurimi i qeramikës së Tjerrtores është bërë me anë të inçizimit, me motive meandrash të regullta e të paregullta, të ngjashme me ato të qeramikës së Vinçës, Gradacit dhe Ploçnikut. Gjithashtu në qeramikën dhe në plastikën e Tjerrtores ndeshet edhe zbukurimi *crusted* (lyerja e hapësirave midis motiveve me bojë të kuqe që fshihet), karakteristik për mbarimin e neolitit të Vinçës.

Plastika e kultit përfaqësohet nga ekzemplarë të shumtë të plastikës monumentale⁹⁸, si dhe kapakët prozomorfikë të inçizuar dhe të inkrustuar me bojë të kuqe dhe është e ngjashme me plastikën e fazës së Vinçës plloçnike, në shtresat e thellësisë 5-4m të Vinçës⁹⁹.

Analogjitë e shumta të qeramikës dhe të plastikës dëshmojnë për përfshirjen e Tjerrtores II në grupin kulturor të Vinçës si dhe për lidhje të ngushta reciproke me kulturën e vendbanimeve të Vinçës si Vallaçi, Plloçniku, Gradaci dhe vetë Vinça, të ardhura nëpërmjet luginës së Moravës¹⁰⁰.

Megjithë analogjitë e shumta me Vinçën dhe vendbanimet e rrethit vinçiak, në këtë vendbanim gjenden edhe disa veçori specifike lokale, gjë që e dallojnë atë prej atij të grupit vinçiak. Kështu në qeramikën e inçizuar të Tjertores shfaqet një teknikë e re e inçizimit të ornamenteve, siç janë shiritat e mbushur me vija të shkurtëra, me origjinë adriatikase (Danilo III-IV), disa motive të së cilës shfaqen edhe në Novipazar, që janë krejtë të panjohura për vetë Vinçën¹⁰¹. Gjithashtu si shfaqje lokale konsiderohen edhe prirjet realiste të trajtimit të plastikës monumentale, që përveçse në Tjertore ndeshet edhe në Vallaç, si dhe disa objekte të kultit prej balte të pjekur, siç është ai figurës shtazore me krye njeriu, e njohur edhe në vendbanimin fqinj të Vallaçit, ai i kokës së gjarpërit etj. Janë këto veçori lokale kulturore, që i kanë shtyrë studiuesit për ta emërtuar kulturën e kësaj faze në Rrafshin e Kosovës si “*variante moravo-jugore e zhvilluar e kulturës Vinça*”¹⁰².

5. Valaç

Vendbanimi i Valaçit gjendet në afërsi të Mitrovicës dhe zë një hapësirë të vogël në një gropë të kreshtës shkëmbore të Valaçit. Është gërmuar në vitin 1955¹⁰³. Ai përfaqëson vendbanimin e vetëm neolitik me mbrojtje të fuqishme natyrore nga tri anë, përkatësisht nga shkëmbinj natyrorë, humnera dhe lumi i Ibrit. Ana e tij jugore, e vetmja anë e afrueshme ka qenë e fortifikuar me ledhe gurësh të përforcuar me polisade shtyllash druri. Këto elementë që e dallojnë mjaft Vallaçin nga vendbanimet e tjera vinçiake të Moravës jugore dhe të Danubit të poshtëm, i japin atij karakterin e një vendbanimi të mbrojtur dhe dëshmojnë mbi rrethanat dramatike në fazën e kalimit prej epokës së gurit në atë të metalit në këto vende, të lidhura me shfaqjen e grupeve të reja kulturore. Karakteristikat e këtij vendbanimi përcaktohen nga pozita specifike jo e zakonshme e vendbanimit në kuadrin e kulturës vinçiake dhe plastika jashtëzakonisht e pasur dhe me ngjyra lokale e

⁹⁸ M. Garasanin, *Centralnobalkanska...* f. 190, tab. XXX-XXXI.

⁹⁹ Po aty.

¹⁰⁰ Po aty.

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² N. Tasiæ, *Završna Istraživanja na Praistorijskom Naselju kod Valaèa*, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, IV-V, Priština 1959-1960, f. 11-52, tab. I-XXV; Po ai, *Introduction to the prehistory, antiquity and early Middle Ages in Kosovo and Metohija*, Arheološko Blago Kosova i Metohije od neolita do ranog credneg veka, Beograd 1998, f. 23.

¹⁰³ N. Tasiæ, *Introduction to the prehistory...*, f. 23.

tij. Materiali qeramik i takon kryesisht kulturës vinçiake, megjithatë, në një pjesë të tij shihet prirja e formimit të një stili të ri dekorativ, që në vija të përgjithshme mund të lidhet me ngjarjet kulturore në Moravën jugore, në Bullgarinë jugore e në Maqedoni në kohën e kalimit nga neolitit i vonë në periudhën eneolitike. Ky material jo vinçik në Vallaç paraqet analogji me vendbanimet e Bullgarisë të tipit Veselinovo-Sveti Kirilovo, si dhe atyre të Moravës jugore, që i takojnë fazës I a të grupit Bubanj Hum.

Ornamentika në plastikën e Valaçit, duke përjashtuar kanelyrën shumë të shpeshtë, largohet nga teknika dhe kompozicioni themelor i mënyrës së dekorit në kulturën vinçiake. Elementë “jo vinçiakë” në ornamentikë janë të shumtë, si : sipërfaqe katërkëndëshash, trekëndësha të vargëzuar, një derivat i spirales me gërricje, shiritat plastik etj. Të gjitha këto elementë tregojnë për formimin e një stili lokal, të një varianti të ri në kulturën vinçiake. Në pikëpamje kronologjike, Valaçi është thujse i njëkohshëm me fazën më të hershme të Bubanj Humit I a nga njera anë dhe me atë të Vinçës së vonë nga ana tjetër.

6. *Fafos II*

Veglat e punës prej guri përfaqësohen nga sëpata të tipeve më të hershme në formë kallëp këpuce. Të tërheq vëmendjen gjetja e një sëpate-çekan e thyer guri, me brimë të rishpuar pas thyerjes. Në veglat e strallit përmendim thikat dhe disa maja shigjetash me fletë rombike, ndërsa në ato të kockës duhen përmendur fëndyejt. Qeamika mbizotërohet nga ajo me fakturë mestare me ngjyrë zakonisht gri të erët ose të zezë. Me format e saj të zhvilluara, kryesisht bikonike dhe dekorin e inçizuar meandrik, edhe antropoplastikën e variantit moravo-jugor kosovar të zhvilluar të kulturës së Vinçës, shtresa Fafos II do t'i korrespondonte fazës më të re Vinça-Ploçnik të kulturës së Vinçës. Faza Fafos II do të sinkronizohej me horizontin më të ri të Predionicës dhe me lokalitetin me kulturë të Vinçës së vonë në Vallaç.

Si karakteristikë e përbashkët për kulturën e neolitit të vonë të fazës Vinça-Ploçnik në Rrafshin e Kosovës, duhet përmendur plastika antropomorfe mjaft e zhvilluar, me prirje realiste, që përbën një nga tiparet e rëndësishme të variantit moravo-jugor kosovar të kulturës së Vinçës¹⁰⁴.

II. Eneoliti.

Qytetërimi eneolitik në Rrafshin e Dukagjinit është përfaqësuar më mirë në vendbanimin shumështrësor të Hisarit të Suharekës(Hisar II)¹⁰⁵ dhe në atë të Vlashnjës së Prizrenit (Vlashnje III)¹⁰⁶, si dhe në një shtresë të hollë të vendbanimit të Hisarit të

¹⁰⁴ M. Garaćanin, *Centralnobalkanska zona, Juznamoravska i Kosovska Varijanta, Vinčanska grupa*, Praistorija Jugoslavenskih Zemalja II, Sarajevo 1979, f. 189-190, tab.XXXIII, 1-4.

¹⁰⁵ J.Todoroviæ, *Die Grabung Hissar und ihre verhältnisse zum Aeneolithikum und der Frühen Bronzezeit*, AY IV, Beograd 1963, f. 25-28, tab. I-V.

¹⁰⁶ A. Bunguri-Sh. Gashi, *Raport mbi gërmimet e vitit 2006 në Vlashnje*, Arkivi i Institutit. Arkeologjik, Prishtinë

Kastercit¹⁰⁷ (Suharekë), në Nishor të Suharekës¹⁰⁸ ndërsa gjurmë të pakta të saj janë ndeshur edhe në shpellën e Zatriçit (Rahovec)¹⁰⁹. Në Rrafshin e Kosovës vendbanimi më mirë i njohur eneolitik është ai i Gadimes së Epërme (Lipjan), ndërsa elementë të kësaj kulture janë zbuluar edhe në një depozi të Glladnicës (Glladnicë II). Vendbanimet e kësaj periudhe janë vendosur në tarraca lumore me mbrojtje natyrore (Hisar, Kasterc, Vlashnje, Gadime), pllaja kodrinore (Nishor) si dhe në shpella (Zatriç).

1. Gadime e Epërme

Ndodhet pranë Lipjanit, në një pozicion dominues, sidomos në drejtim të perëndimit. Ngrihet në një lartësi mesatare në anën juglindore të fshatit eponym. Përbëhet nga dy tarraca që shkallëzohen poshtë sheshit të majës. Gërmimet e bëra në pllajën e majës së kodrës si dhe në tarracën poshtë saj, kanë konstatuar 3 shtresa kulturore me hiatus kronologjik midis tyre. Shtresa më e hershme Gadime I karakterizohet nga një qeramikë e paktë e grafituar dhe forma enësh tipike edhe për Maliqin II, si pjatanca trungkonike me buzë të përthyer nga brenda dhe të pajisur me një syth nën buzë, pjata të cekta me buzë të trashura eliptike, në ndonjë rast të pajisura edhe me kanelyra etj. Kultura e kësaj shtrese sinkronizohet me fazën Bubanj Hum I a dhe i paraprin shtresës Hisar II dhe asaj Maliq II a-b.

2. Hisari II

Hisari përfaqëson vendbanimin më përfaqësues të eneolitikit kosovar me trashësinë e shtresës kulturore 1.70-1.80 m. Nga pikëpamja stratigrafiko-kulturore ajo zhvillohet nëpërmjet 4 fazave evolutive, të emërtuara Hisar I a-b dhe II a-b¹¹⁰. Fazat Hisar I a-b i korrespondojnë fundit të fazës I a dhe fazës I b të grupit Bubanj-Hum të Moravës jugore. Faza Hisar II a përputhet me fazën Bubanj-Hum II dhe grupin Baden-Kostolac të pellgut danubian, ndërsa faza Hisar II b, e konsideruar fillimisht si e bronzit të hershëm të tipit Kritsana të Maqedonisë¹¹¹, më vonë rivlerësohet si e periudhës së hekurit të hershëm¹¹². Sipas N. Tasiq faza Hisar I a i takon eneolitikut të hershëm me elementë të neolitikut të vonë adriatikas, ndërsa faza Hisar I b fazës më të re të grupit Bubanj – Salkuca (Salkuca IV). Faza Hisar II a lidhet me fillimin e grupit Kostolac, ndërsa ajo Hisar II b me hekurin e hershëm të tipit Bellaçevc¹¹³, e riemërtuar më vonë si fazë Hisar III a¹¹⁴.

¹⁰⁷ S. Fidanovski, Z. Nedelkoviæ, *Hisar-Kasterc, Eneolitsko naselje, ranivizantijsko utvrdenje i srednovekovna nekropola*, AP 1986, Ljubljana 1987, f. 4-5.

¹⁰⁸ Sh. Gashi, *Vendbanimi prehistorik i Nishorit* (gërmime të vitit 2007, dorëshkrim).

¹⁰⁹ A. Bunguri-K. Luci-T. Kastrati, *Qendraprehistorike, Harta Arkeologjike e Kosovës, Prishtinë 2006*, f. 58, tab. I, 3-7.

¹¹⁰ J. Todoroviæ, *Die Grabung Hissar und ihre verhältnisse zum Aeneolithikum und der Frühen Bronzezeit*, AY IV, Beograd 1963, f. 25-28.

¹¹¹ J. Todoroviæ, *Hisar, Suva Reka, Prizren*, Archeološki Pregled, 3, Beograd 1961, f. 34.

¹¹²; Po ai, *Die Grabung Hisar und ihre verhältnisse zum Aeneolithikum und der Frühen Bronzezeit*, AY, IV, Beograd 1963, f. 25-28.

¹¹³ N. Tasiq, *Bubanj-Salcuta-Krivodol Kompleks*, PJZ III, Eneolitsko Doba, Sarajevo 1983, f. 90-92; Po ai, *Eneolithic Cultures of Central and West Balkans*, Beograd 1995, f. 131-132; Po ai, *The Eneolithic... ATKM from the Neolithic to the Early Middle Ages*, Beograd 1998, f. 93-115.

¹¹⁴ *ATKM from the Neolithic to the Early Middle Ages*, Beograd 1998, Katalog nr. 97.




Fig. 7. Hisar- Profili lindor i kuadratit II (2004).

Sipas gërmimeve të viteve të fundit në Hisar, dallohen qartë stratigrafikisht 9 horizonte banimi, kronologjikisht të lidhura me neolitit e vonë, eneolitit, bronzin e hershëm dhe epokën e hekurit. Shtresa eneolitike e Hisarit ndahet në 4 horizonte të lidhura me të gjitha fazat evolutive suksesive të zhvillimit të kësaj kulture, përkatësisht me fazat Hisar II a-b dhe II c 1-2¹¹⁵ (fig. 7). Faza Hisar II a i referohet eneolitit të hershëm të tipit Bubanj – Hum I a, faza Hisar II b eneolitit të zhvilluar të sinkronizuar me fazat Bubanj-Hum I b-II (Moravë jugore), Krivodol IV (Bullgari veriore), Salkuca IV (Rumani) dhe Karanovo VI (Bullgari jugore), faza Hisar II c₁ i përket eneolitit të grupit Baden Kostolac dhe faza Hisar II c₂ - eneolitit të vonë të këtij grupi kulturor të

¹¹⁵ A. Bunguri-Sh. Gashi, *Të dhëna të reja mbi kronologjinë e Hisarit*, Kosova Arkeologjike, Prishtinë 2006, f. 14-16.

përzier me elementë të bronzit të hershëm të tipit Bubanj Hum III¹¹⁶. Faza Hisar II c₁ i përket eneolitit të tipit Baden Kostolac, dhe ajo Hisar c₂ fazës së vonë të këtij grupi kulturor, që përmban disa elementë të bronzit të hershëm të tipit Bubanj Hum III¹¹⁷ dhe Maliq III a¹¹⁸.

Në format kryesore të fazës Hisar II a përmendim kupat me profil S-je, shpesh të zbukuruara me kanelyra (tab. IX, 1-3, 5), identike me kupa të tilla të kompleksit Bubanj Hum-Salkuca-Krivodol¹¹⁹, enët me dy vegjë në zgjerimin e pjesës së poshtme të ashtuquajtura të tipit *Scheibenhenkel type* të horizontit Salkuca IV a¹²⁰ (tab. IX, 4), kupat gjysëmsferike me dy vegjë të zhvilluara mbi grykë, shpesh të zbukuruara me thimtha plastike ose kanelyra vertikale në supe (tab. IX, 7-8), vazot bikonike dyvegjake (tab. IX, 6) dhe ato bikonike she aferike pa vegjë, ose me vjegse të vogla të tejshpuara, të përdorura për varje (tab. X, 1-6), të kompleksit kulturor Bubanj Hum-Salkuca-Krivodol, të njohura në Hisar edhe nga gërmimet e mëparshme¹²¹ Zbukurimi më karakteristikë është ai me kanelyra të pjerrëta, vertikale ose oblike (tab. X, 3-5, 8, tab. X, 3). Me vlerë të veçantë kronologjike dhe kulturore, është edhe zbukurimi në trajtë thimthe plastike, të qarkuar nga 1-2 rrathë koncentrikë shpimesh, që e shtojnë mjaft efektin dekorativ të enës (tab. X, 1-2), të stilit Bubanj Hum I, të konstatuara edhe më parë në këtë vendbanim¹²², të ngjashme me kupa të zbukuruara me të njëjtën mënyrë të Maliqit II a¹²³ dhe grupit Bubanj-Hum I.

Në Hisar II a është gjetur vetëm një fragment ene me pikturim gri, me motiv vijash paralele¹²⁴, i ngjashëm me enë të tilla të qeramikës së pikturuar të Maliqit II a.

Në Hisar II b format me përdorim më të gjërë janë kupat me profilim të theksuar në pjesën fundore, në ndonjë rast të zbukururara me kanelyra vertikale (tab. XI, 1-3), pjatat e cekëta me buzë të fryrë eliptike, të zbuquara ose jo me kanelyra oblike (tab. XI, 4-6), kupat bikonike me fron të lartë trungkonik (tab. XII, 1), enët masive (tab. XII, 4), enë të mbështetura mbi funde me 4 këmbë të shkurtëra, me fushë të zbuquar me zvastikë spirallike (tab. XII, 2) etj. Zbukurimet përfaqësohen kryesisht nga kanelyrat, meandrat spirallike me fushë të mbushur me shpime dhe deri kombinimi i dekorit plastik

¹¹⁶ Po aty, f. 14-16.

¹¹⁷ Po aty, f. 14-16.

¹¹⁸ F. Prendi, *La Civilisation Préhistorique de Maliq*, Studia Albanica, 1966, 1, f. 272; F. Prendi-A. Bunguri, *Bronzi i hershëm në Shqipëri*, Prishtinë 2008, f. 80, tab. XI, XXVII.

¹¹⁹ N. Tasiæ, *Eneolithic Cultures off Central and West Balkan*, Belgrade 1995, tab. IX, 1-2.

¹²⁰ J. Todoroviæ, *Die Grabung Hisar und ihre verhältnisse zum Äneolithicum und der Frühen Bronzezeit*, Archeologica Yugoslavica IV, Beograd 1963, f.27-28, tab. IV.

¹²¹ N. Tasiæ, *Bubanj-Salcuta- Krivodol kompleks*, PJZ III, Eneolitsko Doba, Sarajevo 1979, tab. IX, 9-10, XI, 8.

¹²² N. Tasiæ, *Bubanj-Salcuta- Krivodol kompleks*, PJZ III, Eneolitsko Doba, Sarajevo 1979, tab. X, 1.

¹²³ F. Prendi, *La Civilisation Préhistorique ...*, tab. IX, 6, 9.

¹²⁴ J. Glicicæ, *Pojava ranih bronzanodopskih kultura na Kosova i Metohiji*, "Glasnik Muzeja Kosova i Metohije", VI, Prishtinë 1961, f. 140.

me shpime rrethore etj. Me këto elementë kulturorë faza Hisar II b përputhet me fazat I b – II të grupit Bubanj – Hum të Moravës Jugore, Krivodol IV dhe Salkuca IV të Bullgarisë veriore dhe Rumanisë jugore si dhe Karanovo VI të Bullgarisë jugore¹²⁵.

Faza Hisar II c₁ stratigrafikisht është e lidhur me horizontin e banesave të thellësive 150-160 m dhe në pikpamje kulturore i referohet grupit Kostolac. Shtresa kulturore, me trashësi 0.15m, me përmbajtjen e lartë të rërës së imtë dhe hirit të zjarrit, dëshmon se vendbanimi i është nënshtruar një djegie dhe shkatërrimi të dhunshëm. Ky ndryshim stratigrafik pasqyrohet dhe në ndryshime arkitektonike pasi dyshemetë e banesave të këtij horizonti janë shumë kompakte dhe pajisen me një vatër të madhe rrethore, të lidhur me banesa më të mëdha se ato të horizonteve të mëparshme. Gjithashtu ndryshime pasqyrohen edhe në përmbajtjen dhe fizionominë e kulturës së kësaj faze e cila përmban mjaft elementë të grupit Kostolac siç janë tasat gjysëmferikë të zbukuruar me shpime të tipit Kostolac (tab. XIII, 5-7)¹²⁶ etj. Faza Hisar c₂ në pikpamje stratigrafike mbyll epokën eneolitike dhe mbulohet nga një hiatus kulturor prej aluvionesh suargjilore me trashësi 8-10 cm, pas të cilit vijojnë depozitimet e periudhës së hershme të hekurit. Në pikpamje arkitektonike karakterizohet nga banesa me përmasa të mëdha të pajisura me një vatër katërkëndëshe me bordurë të drejtë anësore, identike me ato të Maliqit III a në Shqipëri. Në pikpamje kronologjiko-kulturore i takon fazës së eneolitit të vonë, por me disa elementë të bronzit të hershëm dhe në këtë kuptim përfaqëson një fazë tranzitore midis eneolitit dhe epokës së bronzit. Në format kryesore të enëve përmendim enët me qafë cilindrike ose konike, shpesh të zbukuruara me kanelyra (tab. XIII, 1-2) ose me shpime të tipit Kostolac (tab. XIII, 8-9), vazot sferike, me buzë të zbukuruara nga jashtë me gropëzime gishti (tab. XIII, 3-4), filxhanët e tipit Baden (tab. XIII, 10-11) etj. Komponenti kostolacas do të marrë pjesë aktive në formimin e kulturës së bronzit të hershëm Hisar III a, krahas komponentes së ardhur me anë të dyndjeve të bronzit të hershëm.

3. Shpella e Zatriçit (Rahovec)

Ndodhet në një masiv shkëmbor të njohur me emrin “Gërgavica” në shpatet lindore të Gradishtës së Zatriçit, afër fshatit homonim. Hyrja e shpelles e orientuar nga verilindja ka lartësi 3.70 m dhe gjerësi 4.00 m, ndërsa korridori i saj me gjerësi 3.30-5.00 m dhe lartësi 2.00-7.50 m është 26 m i gjatë. Nga një sondazh me përmasa 1.00x1.00 m, i hapur në gjatësinë 16 m të korridorit u zbulua një shtresë e hollë depozitimesh kulturore me trashësi 0.20 m (fig. 8). Fragmentet e enëve eneolitike riprodhojnë enë sferike të ngjashme me ato të Hisarit (tab. XIV, 1), të punuara me qeramikë mesatare bezhë me lustër të dobët me ngjyrë okër (tab. XIV, 2-3), kupa gjysëm sferike me grykë të prerë, kupa të vogla të punuara me qeramikë të hollë me lustër të zezë me shkëlqim, tipike

¹²⁵ F.Prendi, *La Civilisation Prehistorique ...*, tab. IX, 6, 9.

¹²⁶ N. Tasiæ, *Eneolithic Culturess of Central and West Balkan*, Belgrade 1995, tab. XX, 5, XXI, 2-4.




Fig. 8. Zatriç - Pamje e shpellës dhe planimetria e saj.

për periudhën eneolitike (tab. XIV, 4-8). Me këtë datim përputhet edhe dekori i gërvishtur para pjekjes i enëve sferike, me motivin e rombeve të vargëzuar, i njëjtë me motive të tilla të vazove eneolitike të Hisarit II¹²⁷ dhe në përgjithësi të fazës së hershme dhe asaj të zhvilluar të grupit kulturor të Badenit¹²⁸.

¹²⁷ *Arheolosko Blago Kosova I Metohije od neolita do ranog sredneg veka*, Katalog, Beograd 1998, nr. 97.

¹²⁸ N. Tasiæ, *Eneolithic Culturess...*, tab. XVI, 3, XVII, 3.

4. *Vlashnje IV*

Shtresa eneolitike në vendbanimin e Vlashnjës, me trashësi 0.15-0.20m, nuk është kompakte si në Hisar dhe gjendet në pjesë të kufizuara të vendbanimit. Stratigrafikisht ajo është vendosur pa hiatus mbi depozitimet e Vinçës së vonë (kuad. C III), mbi një dysheme të hollë balte të pjekur e të plasarit. Elementi më karakteristikë për këtë periudhë është poçeria gri e zezë dhe e zezë dhe ajo me lustër te zeze me shkëlqim. Format më të shpeshta janë kupat gjysëm sferike me vegjë të zhvilluara mbi grykë (tab. XV, 1-2), kupat bikonike dhe me profil në forme S-je (tab. XV, 3), enët sferike me grykë të mbledhur nga brenda dhe buzë lehtë të profiluara (tab. XV, 4-5), enët sferike me qafë cilindrike dhe përforcim të jashtëm unazorë të buzës (tab. XV, 6) etj. Zbukurimet janë te pakta dhe përfaqësohen nga kanelyra vertikale (tab. XV, 3) dhe më rrallë brinjë plastike me hapësirë të mbushur me shpime të vogla e të dendura (tab. XV, 7) etj. Objektet e kultit përfaqësohen nga pintaderat me fushë të inçizuar me motive të valëzuara (tab. XV, 8). Në vija të përgjithshme Vlashnja III përsërit tiparet kulturore të Hisarit II (a-b) (Suharekë), dukuri e pritshme nga pozicioni gjeografik i saj në zonën kalimtare nga ajo adriatikase në atë ballkano-qëndrore. Por ndryshe nga Hisari në Vlashnje aktualisht nuk kemi përfaqësime kulturore të grupit të Baden-Kostolacit. Kultura eneolitike e Vlashnjës është e ngjashme me kulturën eneolitike të Gadimes së Epërme¹²⁹ në Rrafshin e Kosovës dhe është pak më e vonë se ajo si dhe me atë Maliq II a-b¹³⁰ në Shqipëri. Në pikëpamje të kronologjisë relative Vlashnja III i përgjigjet fazës Bubanj Hum I b.

Për të krijuar një pamje më të plotë të qytetërimit neolitik dhe eneolitik të hapësirës së Kosovës, po japim një tabelë kronologjike të sinkronizimit të përafërt të kulturave të saj me ato të kulturave bashkëkohëse të viseve fqinje dhe më të largëta të Ballkanit qëndror e atij lindor (fig. 9).

Përfundime:

Kërkimet arkeologjike të kryera në Kosovë kanë dëshmuar se gjurmët më të hershme të banimit i takojnë epokës së largët të paleolitit, ndërsa banimi i saj intensiv fillon në neolitin e hershëm. Arkeologjikisht është provuar se përfaqësimet më të hershme neolitike në Kosovë i përkasin fazës së hershme të neolitit të hershëm ballkano-qendror, të njohur si faza protostarçevo dhe Starçevo I. Kjo fazë e hershme paraklasike e qytetërimit neolitik, është përfaqësuar nga horizontet e banimit në Rudnik I dhe Gjonaj të Rrafshit të Dukagjinit, dhe gjasisht dhe në atë të Batovcit në Rrafshin e Kosovës.

Kultura e kësaj faze përcaktohet nga qeramika trashanike, ku shquhen dy kategoritë kryesore të saj, qeramika impresso dhe ajo barbotine, si dhe qeramika e hollë monokrome

¹²⁹ N. Tasić, *Bubanj-Salkuca-Krivodol kompleks...* f. 90-92, tab. IX, 3, 8, 10; X, 1-4, 7; XI, 6, 8; XII, 1, 3, 5.

¹³⁰ F. Prendi, *La civilisation prehistorique de Maliq*, Studia Albanica, 1, 1966, f. 257-262, tab. III-XI.

Periudha	Thesali	Shqipëri	Rr. Dukagj	F. Kosovës	Pelagoni	Dalmaci	Bosnje	Serbi	Bullgari
Neolit i hershëm I	Protosesklo i vonë Prodrrom	Burim I	Gjonaj Rudnik I	Batovc	Nea Nikomed ia	Cardium impresso I	Starçevo impresso I	Protostarçevo-Starçevo I	Karanovo I
Neolit i hershëm II	Presesklo Sesklo e hershme	Podgori I- Vashëmi Kolsh I Blaz II	Rudnik II-III Vlashnje I a-b	Zhitkovac I Karagaç I Glladnicë I a-b.	Velushka tumba e hershme I-II Anzabeg ovo-Vrshnik la.bc.	Cardium impresso II	Starçevo impresso II	Starçevo II a-b	Karanovo II
Neolit i mesëm Vinça-Tordosh I-II	Sesklo Elatea II	Protocakran Cakran Kolsh II Blaz III Topojan I	Reshtan Vlashnje II a	Tjerrtore I a-b Fafos Ia-b Zhitkovac II	Anzabeg ovo-Vrsnik II-IV Velushka tumba IV Servia V	Protodanilo Danilo I-II	Protokakanj Kakanj II-III Kakanj III-Butmir I	Starçevo III Vinça A 1-2 Vinça-Tordosh II a-b Vinça B 1	Karanovo III
Neolit i vonë Vinça-Ploçnik I-II	Dimini III-IV(klasik) (Otzaki) Tsangli Dimini Arapi Otzaki Larisa klasike ? Rrahmani	Maliq I-Kammik Barç II Dersnik Topojan II	Reshtan Hisar I Vlashnje IIb	Tjerrtore II Fafos II Valaç Bardhosh Barilevë Gërçar	Ustie na Drim I	Danilo III-IV-Hvar I Lisiç	Butmir II-III	Vinça B2/C faza Gradac Vinça-Ploçnik I-II a-b Bubanji Hum I a	Karanovo IV Karanovo V(Marica) Karanovo VI Ezero I
Eneolit	Rrahmani I	Maliq II a-b Nezir II	Hisar II a-c Vlashnje III Nishor Zatriç	Gadime I Glladnicë II	Ustie na Drim II Shuplave c-Bakarno-Gumno I-II	Vuçedol	Kostolac	Vinça C/D Bubanji Hum I a-b	Ezero II

Fig. 9. Tabelë kronologjike e kulturave neo-eneolitike të Kosovës.

e kuqe me lustër, pa qeramikë të pikturuar. Format më të zakonshme të enëve janë ato sferike e gjysëm-sferike me funde unazorë, dhe vegjë kryesisht tunelore, shpesh vertikalisht të tejshpuara. Këto elementë kulturorë të kujtojnë në përgjithësi tiparet e fazës Burim I si dhe ato të fazës më të hershme të grupit kulturor të Starçevos (Starçevo I), me të cilën lidhet pa dyshim edhe kultura e Rudnikut I, qoftë dhe si një variante periferike juglindore e saj.

Lidhur me pozitën kronologjiko-kulturore të shtresës Rudnik I, mund të thuhet se kultura e saj sinkronizohet me atë të fazës Presesklo dhe Protosesklo të Thesalisë, kulturën Burim I në Shqipëri dhe atë Karanovo I në Bullgari. Akoma nuk dihet me siguri nëse kultura e fazës Rudnik I e paraprin atë të fazës Anzabegovo I-Vrsnik dhe është më afër Protosesklos, apo përfaqëson një kulturë më të vonë, pasi kultura e

vendbanimit të Rudnikut ende nuk është vënë në qarkullim shkencor. Megjithatë është evidente se që në këtë fazë të hershme të zhvillimit neolitik, Kosova përfshihej brenda arealit të grupit starçevian të Ballkanit qendror të kompleksit të gjërë ballkano-anatolik të neolitit të hershëm. Kjo traditë do të vazhdojë të fuqizohet më tej gjatë fazës së zhvilluar klasike Starçevo II b të neolitit të hershëm, kur kjo kulturë shënon ekspansionin më të madh nga Ballkani qendror drejt jugut e jugperëndimit.

Në fazën II të neolitit të hershëm, shtohet dukshëm numri i vendbanimeve me kulturë tipike starçeviane, rrjedhojë e drejtpërdrejtë e shtimit numerik të popullsisë. Në Kosovë ajo përfaqësohet nga shtresat Rudnik II-IV, Vlashnje I a-b, Glladnicë I a-b, Zhitkovac I, Karagaç I etj. Në pikpamje kronologjike kulturore ajo sinkronizohet me fazat Starçevo II a-b të Ballkanit qendror, atë Anzabegovo I (a,b,c) dhe Velushka tumba në Pelagoni, atë Sesklo në Thesali etj. Karakteristikë për këtë fazë të neolitit të hershëm kosovar është poçeria monokrome e kuqe, ajo barbotine dhe impresso. Në fazën Vlashnje I a, shfaqet në një ekzemplarë të vetëm qeramika e pikturuar me ngjyrë të bardhë mbi sfond të kuq, me motive gjeometrike. Megjithëse aktualisht kjo teknikë dekorative është përfaqësuar vetëm nga një fragment, dukuri e njohur më parë edhe në Kolsh I, ai mjafton për ta sinkronizuar këtë fazë të zhvillimit neolitik të Vlashnjës me fazën Starçevo II a-Rudnik II, Anzabegovo-Vrœnik I, atë Vashtëmi-Podgori Ia-b, si dhe me fazën protosesklo të Thesalisë, dhe atë të Nea Nikomedias kur shfaqet kjo teknikë dekorative. Gjithashtu ai vlen për të menduar se rrugëpërhapja e kësaj teknike dekorative nga pellgu i Korçës në pellgun e dy Drinave (Kolsh) dhe Drinit të Bardhë (Vlashnje) duhet të jetë arteria e Drinit të Zi. Pikturimi me bojë të bardhë mbi sfond të kuq, që shfaqet në fazën Rudnik II, për t'u zhdukur në atë Rudnik III, është një dukuri e konstatuar më parë në fazën Starçevo II a, për të dalë nga përdorimi në atë Starçevo II b.

Në horizontin e dytë Vlashnje I b, vihet re një larmi më e madhe e formave të enëve, në të cilat, përveç atyre sferike (tab. II, 1-4) e trungkonike (tab. II, 5-8), shfaqet prirja e bikonizimit morfologjik të tyre (tab. II, 4), gjë që është tipar i fazës fundore të neolitit të hershëm. Gjithashtu shfaqet për të parën herë dekori i pikturuar me ngjyrë kafe mbi sfond të kuq, me motive linearo-gjeometrike, i një stili të pjekur të tipit Starçevo II b (tab. III, 2-4, XV, 3-8), që e vë në lidhje qeramikën e pikturuar të Vlashnjës me atë të Rudnikut II-III dhe Kolshit I dhe Starçevo II b. Gjithashtu kjo kulturë është konstatuar stratigrafikisht edhe në Rudnik II-III, Rakosh, Çupevë e Ulët, Kramovik të Rrafshit të Dukagjinit dhe Glladnicë dhe Zhitkovac I të Rrafshit të Kosovës. Pikërisht gjatë fazës Starçevo II b, që përkon me fazën e zhvillimit klasik të grupit kulturor Starçevo, shënohet ekspansioni më i gjërë i tij në të gjithë Ballkanin qendror e lindor, që nga rrafshi i Shkupit në jug deri në Panoni në veri, dhe nga Bosnja qendrore dhe Shqipëria verilindore në perëndim deri në fushën e Sofies në lindje.

Jeta shpirtërore është relativisht mirë e përfaqësuar nëpërmjet tavolinave ose altarëve të kultit me 4 këmbë, zakonisht të zbukuruara me inçizim të thellë gjeometrik (tab. III, 8), të ngjashme me ato të Kolshit I të grupit kulturor Starçevo II a-b. Elementët e mësipërm morfologjik

dhe stilistik e dekorativ e përfshijnë shtresën Vlashnje I a-b në fazat II a-b të grupit kulturor Starçevo të Ballkanit qëndror, qoftë dhe si një variant periferik juglindor të saj.

Kultura e neolitit të mesëm në Kosovë përfaqësohet aktualisht nga shtresat Vlashnje II, Reshtan, dhe Hisar I në Rrafshin e Dukagjinit dhe Tjerrtore I a-b, Fafos I a-b dhe Zhitkovac II në Rrafshin e Kosovës.

Në pikpamje topografike edhe në këtë periudhë janë përfaqësuar dy tipe vendbanimesh, si ata të vendosura në fusha aluvionale (Tjerrtore, Fafos, Zhitkovac) ashtu edhe ata të vendosura në tarraca me mbrojtje natyrore (Vlashnje, Pogradë).

Kultura e neolitit të mesëm të Kosovës sinkronizohet me atë të fazës Vinça-Tordosh I-II të Ballkanit qëndror. Në këtë fazë të zhvillimit të kësaj kulture, i gjithë territori i Kosovës mbulohet nga kultura e hershme vinçiake. Ajo dallohet për format e reja të enëve, sistemin e ri dekorativ si dhe për plastikën e zhvilluar dhe të larmishme zoomorfe dhe antropomorfe të saj. Nder format me kryesore permendim enët bikonike me buzë të kthyer lehtë nga jashtë (tab. IV, 1-3), enët bikonike me qafë cilindrike dhe vegjë në trajtë briiri (tab. IV, 5), enët sferike me grykë të mbledhur nga brenda (tab. IV, 4) ose me qafë të lakuar (tab. IV, 6), kupat dykonike të zbukuruara me thimtha plastike në vijën e karinimit (tab. IV, 7-10), kupat me profil S-je (tab. IV, 11-12) etj. Në teknikat e reja dekorative, vendin kryesor e zënë brezat e inçizuar të mbushur me shpime të stilit të hershëm vinçiak (tab. IV, 1-4, V, 1-5), dhe në ndonjë rast të kombinuar edhe me thimtha plastike në supe (tab. IV, 1), thimthat plastike cilindrike ose eliptike, që paraqiten të vendosura në formë teke ose në çifte përkundraill (tab. IV, 2, 7, 8-9), si edhe në trajtë brezash horizontale të mbushur me thimtha cilindrike (tab. V, 11) apo thimtha eliptike në trajtë brinjësh vertikale (tab. V, 9), inçizimet me vija të thelluara me motive lineo-geometrike të vijëzuara në mënyrë alternative (tab. V, 6-8, 10), dhe shumë rrallë edhe kurbolineare (tab. V, 12) etj. Forma enësh të ngjashme, të zbukuruara me ornamente plastike të gjetura në Pogradë, e përfshijnë këtë vendbanim në të njëjtën fazë zhvillimi me atë të Vlashnjës II. Format e mësipërme të enëve dhe teknikat dekorative të tyre, të kujtojnë format klasike të fazës Vinça –Tordosh I- II të neolitit të mesëm ballkano-qëndror, dhe më saktë i variantit kosovar të kulturës Vinça, me të cilin duket qartë se Vlashnja II a dhe Pogradë I përputhen në treguesit e tyre më kryesorë.

Në pikpamje kronologjike ajo sinkronizohet me fazat Vinça A₁-A₂ në Serbi, ato Anzabegovo-Vrsnik II-IV, Velushka tumba IV dhe Servia V në Pelagoni. Kjo kulturë mesoneolitike u zhvillua në të njëjtin territor ku më parë vepronte grupi i Starçevos, por akoma nuk është plotësisht e qartë nëse kalimi nga kultura e tipit Starçevo të neolitit të hershëm në atë mesoneolitike të Vinçës, erdhi si rezultat i vendosjes së grupeve të reja kulturore në këto treva të Ballkanit qëndror, apo i evolucionit të brendshëm kulturor, i shoqëruar nga ndikimet e jashtme me prejardhje verilindore.

Kultura e neolitit të vonë i korrespondon fazës më të re Vinça-Ploçnik I të kulturës Vinça. Ajo njihet stratigrafikisht nga shtresa Tjertore II dhe Bardhosh, Fafos II dhe

Vallaçi në Rrafshin e Kosovës që përfshihen në variantin moravo jugor kosovar të zhvilluar të Vinçës, si dhe nga Reshtani, Hisari I dhe Vlashnje III në Rrafshin e Dukagjinit.

Në këtë fazë konstatohet një dukuri e re kulturore në zhvillimet neolitike në Kosovë, që shprehet në raportin e influencave adriatikase dhe atyre ballkano qëndrore, përkatësisht në Rrafshin e Kosovës dhe atë të Dukagjinit. Kultura e kësaj faze në Rrafshin e Kosovës riprodhon tipare të grupit neolitik të vonë të Vinçës(faza Vinça-Ploçnik), me origjinë kontinentale, i cili në Kosovë paraqitet si një variante lokale, e njohur me emrin “*variantja moravo-jugore kosovare e zhvilluar e kulturës Vinça*”. Në Rrafshin e Dukagjinit, krahas elementëve vinçiak të vonë të ardhur deri këtu nëpërmjet impulseve të këtij varaianti, shfaqen edhe bartësit e kulturës së Danilo, me origjinë adriatikase, madje këto të fundit, me një epërsi sasiore. Bashkëjetesa paqësore e elementëve adriatikas dhe atyre vinçiakë, e konstatuar për herë të parë në Reshtan, përsëritet edhe në Hisar I dhe Vlashnje III, si edhe në Kolsh II(Kukës). Ky fenomen i përsëritur në këto 4 vendbanime gjeografikisht shumë të afërta, flet për një veprim aktiv të kulturës adriatikase të tipit Danilo në Rrafshin e Dukagjinit. Gjithashtu elementë të kulturës Danilo depërtojnë edhe në Rrafshin e Kosovës (Tjertore) si dhe në Novipazar, ku më e fuqishme paraqitet komponentja vinçiake, e njohur si variantja moravo-jugore kosovare e zhvilluar e Vinçës. Kjo situatë kulturore, me elementë të përzier të të dy komplekseve kulturorë, është e shpjegueshme për pozitën e ndërmjetme të Kosovës në përgjithësi dhe të Rrafshit të Dukagjinit në veçanti, midis Adriatikut dhe Ballkanit qendror.

Qytetërimi eneolitik në Kosovë aktualisht njihet në një shkallë relativisht të kënaqshme. Në Rrafshin e Kosovës vendbanimi më mirë i njohur eneolitik është ai i Gadimljes së Epërme (Lipjan), ndërsa elementë të kësaj kulture janë zbuluar edhe në një depozitë të Glladnicës pranë Prishtinës (Glladnicë II), ndërsa në Rrafshin e Dukagjinit është përfaqësuar më mirë në vendbanimin shumshresor të Hisarit të Suharekës (Hisar II) dhe në atë të Vlashnjës së Prizrenit (Vlashnje III), në një shtresë të hollë të vendbanimit të Hisarit të Kastercit dhe në Nishor të Suharekës, ndërsa gjurmë të pakta të saj janë ndeshur edhe në shpellën e Zatriçit (Rahovec). Në pikëpamje topografike, vendbanimet e kësaj periudhe janë vendosur në tarraca lumore me mbrojtje natyrore (Hisar, Kasterc, Vlashnje, Gadimlje), pllaja kodrinore(Nishor) si dhe në shpella (Zatriç).

Në periudhën e hershme eneolitike, në Kosovë filluan të depërtonin nëpërmjet luginës së Moravës jugore grupe të reja etno-kulturore, bartës së poçerisë së grafituar të grupit Bubanj Hum I a dhe pak më vonë Bubanj Hum I b dhe më vonë ata të grupit Kostolac dhe Baden. Këto kultura janë zbuluar në Rrafshin e Kosovës në horizontet më të hershme të vendbanimit tarracor të Gadimes, në një depozitë të Glladnicës, ndërsa në Rrafshin e Dukagjinit, në Hisar II dhe Nishor të Suharekës si dhe në Vlashnje IV të Prizrenit, ku është përfaqësuar vetëm kultura e grupit Bubanj Hum Ia-b. Pas gërmimeve në vendbanimin e Hisarit me depozitimet mjaft intensive eneolitike, janë përcaktuar tri faza suksesive, të emërtuara Hisar a-c në zhvillimin e qytetërimit eneolitik të Kosovës.

Fizionomia kulturore e fazës më të hershme Hisar II a përcaktohet nga elementë të grupit kulturor Bubanj Hum siç janë kupat me profil S-je, shpesh të zbukuruara me kanelyra (tab. IX, 1-3, 5), identike me kupa të tilla të kompleksit Bubanj Hum-Salkuca-Krivodol, enët me dy vegjë në zgjerimin e pjesës së poshtme të ashtuquajtura të tipit *Scheibenhenkel type* të horizontit Salkuca IV a (tab. IX, 4), kupat gjysëmsferike me dy vegjë të zhvilluara mbi grykë, shpesh të zbukuruara me thimtha plastike ose kanelyra vertikale në supe (tab. IX, 7-8), mjaft të pëlqyera edhe në Vlashnje III (tab. XIV, 1-2), vazot bikonike dyvegjake (tab. IX, 6) dhe ato bikonike dhe sferike pa vegjë, ose me vjergse të vogla të tejshpuara, të përdorura për varjee (tab. X, 1-6), të kompleksit kulturor Bubanj Hum-Salkuca-Krivodol, të njohura në Hisar edhe nga gërmimet e mëparshme etj. Zbukurimi më karakteristikë është ai me kanelyra të pjerrta, vertikale ose oblike (tab. X, 3-5, 8, tab. X, 3). Me vlerë të veçantë kronologjike dhe kulturore, është edhe zbukurimi në trajtë thimthe plastike në negativ, të qarkuar nga 1-2 rrahë koncentrikë shpimesh, që e shtojnë mjaft efektin dekorativ të enës (tab. X, 1-2), të stilit Bubanj Hum I, të konstatuara edhe më parë në këtë vendbanim, të ngjashme me kupa të zbukuruara me të njëjtën mënyrë të Maliqit II a dhe grupit Bubanj-Hum I.

Në fazën Hisar II b format me përdorim më të gjërë janë kupat me profilim të theksuar në pjesën fundore, në ndonjë rast të zbukururara me kanelyra vertikale (tab. XI, 1-3), pjatat e cekëta me buzë të fryrë eliptike, të zbuquara ose jo me kanelyra oblike (tab. XI, 4-6), kupat bikonike me fron të lartë trungkonik (tab. XII, 1), enët masive (tab. XII, 4), enë të mbështetura mbi funde me 4 këmbë të shkurtëra, me fushë të zbukuruar me zvastikë spiralike (tab. XII, 2) etj. Zbukurimet përfaqësohen kryesisht nga kanelyrat, meandrat spiralike me fushë të mbushur me shpime dhe deri kombinimi i dekorit plastik me shpime rrethore etj. Me këto elementë kulturorë faza Hisar II b përputhet me fazat I b – II të grupit Bubanj – Hum të Moravës Jugore, Krivodol IV dhe Salkuca IV të Bullgarisë veriore dhe Rumanisë jugore si dhe Karanovo VI të Bullgarisë jugore.

Faza Hisar II c₁ stratigrafikisht është e lidhur me horizontin e banesave të thellësive 150-160 m dhe në pikpamje kulturore i referohet grupit Kostolac. Shtresa kulturore, me trashësi 0.15m, me përmbajtjen e lartë të rërës së imtë dhe hirit të zjarrit, dëshmon se vendbanimi i është nënshtruar një djegie dhe shkatërrimi të dhunshëm. Ky ndryshim stratigrafik pasqyrohet dhe në ndryshime arkitektonike pasi dyshemetë e banesave të këtij horizonti janë shumë kompakte dhe pajisen me një vatër të madhe rrethore, të lidhur me banesa më të mëdha se ato të horizonteve të mëparshme. Gjithashtu ndryshime pasqyrohen edhe në përmbajtjen dhe fizionominë e kulturës së kësaj faze e cila përmban mjaft elementë të grupit Kostolac siç janë tasat gjysëmsferikë të zbukuruar me shpime të tipit Kostolac (tab. XIII, 5-7) etj. Faza Hisar c₂ në pikpamje stratigrafike mbyll epokën eneolitike dhe mbulohet nga një hiatus kulturor prej aluvionesh suargjilore me trashësi 8-10 cm, pas të cilit vijojnë depozitimet e periudhës së hershme të hekurit. Në pikpamje arkitektonike karakterizohet nga banesa me përmasa të mëdha të pajisura

me një vatër katërkëndëshe me bordurë të drejtë anësore, identike me ato të Maliqit III a në Shqipëri. Në pikpamje kronologjiko-kulturore i takon fazës së eneolitit të vonë, por me disa elementë të bronzit të hershëm dhe në këtë kuptim përfaqëson një fazë tranzitore midis eneolitit dhe epokës së bronzit. Në format kryesore të enëve përmendim enët me qafë cilindrike ose konike, shpesh të zbukuruara me kanelyra (tab. XIII, 1-2) ose me shpime të tipit Kostolac (tab. XIII, 8-9), vazot sferike, me buzë të zbukuruara nga jashtë me gropëzime gishti (tab. XIII, 3-4, XIV, 6), filxhanët e tipit Baden (tab. XIII, 10-11) etj. Objektet e kultit përfaqësohen nga pintaderat me fushë të inçizuar me motive të valëzuara (tab. XV, 8). Komponenti kostolacas do të marrë pjesë aktive në formimin e kulturës së bronzit të hershëm Hisar III a, krahas komponentes së ardhur me anë të dyndjeve të bronzit të hershëm.

Në periudhën eneolitike braktisen vendbanimet e sheshta aluvionale të tipit Reshtan për të kaluar në vendbanimet me mbrojtje natyrore të tipit Hisar, lëvizje që shpreh nevojën për mbrojtje ndaj valëve të turmave transhumante të grupeve të Bubanjit apo të Kostolacit. Duke u mbështetur në gërmimet tona në Hisar mund të themi se grupet e reja të vendosura këtu, sollën ndryshime jo vetëm në strukturën e vendbanimeve të këtij rajoni gjeografiko-kulturore, por edhe në përmbajtjen kulturore të tyre. Kështu, me ardhjen e grupit Bubanj, merr fund zhvillimi i grupit të Vinçës dhe i Danilos dhe në fazat Hisar II a-b, ashtu si edhe në Vlashnje III vazhdon për një periudhë të gjatë jeta paqësore e tij. Në Hisar, në fazën II C₁ jeta paqësore do të ndërpritet nga grupi i ri dhe i fuqishëm i Kostolacit, që arrin të pushtojë vendbanimin, duke e djegur atë qoftë edhe pjesërisht. Komponentja kostolacase në këtë vendbanim shfaqet mjaft e konsoliduar, dhe si e tillë, do të marrë pjesë aktive edhe në krijimin e kulturës së fazës Hisar III a të periudhës së hershme të bronzit, së bashku me grupet transhumante të mbërritur këtu gjatë valës së fundit të dyndjeve të popujve stepikë të fazës Kurgan IV të mesit të mijëvjeçarit III para Kr. Një situatë e ngjashme paraqitet edhe në vendbanimin shpellor të Zatriçit, me përfaqësime të pakta elementësh të fazës klasike të kulturës Baden. Ndërkaq, kjo komponente kostolacase mungon në vendbanimin e Vlashnjës, ku aktualisht rezulton e përfaqësuar vetëm ajo e grupit Bubanj-Hum I b.

THE NEW DATA ON THE NEOLITHIC AND ENEOLITHIC CIVILISATION OF KOSOVO

Kosova lies in the western part of Central Balkan as a quite distinguished geographical and cultural region of it. It is bordered on south and southeast with Macedonia, on north and east with Serbia, on northwest with Montenegro and on the southwest with Albania. It consists with Rrafshi i Dukagjinit and Rrafshi i Kosovës basins. In the geological viewpoint the basins of Rrafshi i Dukagjinit was formed in a tectonically way, which later had been covered by the water of a large lake. That's why it consists from flat fields with very rich river alluvial deposits with good condition for the development of agricultures and farmers economy. The Kosovo basin flowed by the Ibër-Sitnica-Nerodimka rivers valleys, and the Rrafshi i Dukagjinit one by the Drini i Bardhë river, its valley and its atributes. The basin of Rrafshi i Dukagjinit has a continental clime mixed with mediterranean elements, which have created the very good conditions for life. The geographical position of Kosovo and its free communicative respiration with the neighboring and far away regions have influenced in the definition of this region with historical and cultural background as a contacted area of autochthonic culture with the Adriatic, Aegean and Central Balkan. The favorable geo-climatic conditions that Kosovo generally gains have determined their living in the most ancient periods.

The researches in the prehistoric archaeological field of Kosovo are of a young age and may be divided into two stages:

The real archaeological activity in this region starts with the creation of the Kosovo Museum in Pristine in the year 1949 and was intensified during the years 60-80', coinciding with the most important period of researches in the prehistoric field. During this period have given their worthy contribution in the prehistoric field, some of representatives of the first generation of the archaeologists of the post second world war, who came in Prishtina as high specialists of the Museum such as I. Nikolixë, R. Galovixë, N. Djuri and J. Glisixë, some others from the National Museum of Beograd, such as N. Tasi, B. Jovanovixë etc, as well as the most prominent of the older generation of the archaeologists such as D. Srejavixë, M. Garaanin, J. Todorovixë. Beginning from the middle of the year 70' of the XX century, the albanian archeologists E. Shukriu Hoti, and later on T. Kastrati and Sh. Gashi have contributed in the neo-eneolithic studies in Kosovo.

The second stage started after the liberation of Kosovo, since the year 2000 and going on, when the joint project between Tirana and Pristina started in the archeological field of excavations in Drin i Bardhë valley. An excavation was carried out in Hisar of Suhareka (2003-2004, 2007), four excavation campaigns were conducted at the

multilayer site of Vlashnja (2002, 2006, 2007, 2008), as well as the rescue excavation at Bardhosh near Pristine (2002) etc.

The neolithic civilisation is relatively well represented and studied, regardless the culture of these settlements is not published yet completely. The published material, even little, serves as a sufficient documenting base, to know the main features of eneolithic-neolithic of this region and even to have a partial view of the historical-cultural development of this area, since the earliest periods of Neolithic.

The early neolithic civilization of Kosova is known by 9 settlements, 6 of them are in Rrafshi i Dukagjinit basin. Two of them, respectively Rudniku and Rakoshi, are situated in the slopes of Drenica plateau in Drini i Bardhë, whereas the two others, Lower Cupeva and Kramoviku in the lower field area, in the left side of this river. Rudniku and Lower Cupeva have been excavated by J.Glisiæ respectively during the years 1966-1968, 1984 and 1968-1969. Recently a number of settlements are undertaken as well in the multilayer settlement of Vlashnja. Other early neolithic settlements in Kosovo plain are Glladnica (Prishtina) and Zhitkovac I (Mitrovicë).

Rudniku is an open settlement and the most important one of the Early Neolithic. It is situated in the village with the same name, in Drenica plateau. Although geographically it is part of this plateau, it is included in the reservoir of Drini i Bardhë (Kushavca stream is the left affluent of this river). It is excavated during the years 1966-1968 and re-excavated in 1984 by J.Glisiæ. The cultural layer with a thickness around 2 m, contains 4 dwelling horizons related with the ancient and middle Neolithic. According to the stratigraphic and chronological evaluation Rudnik culture is developed through 4 phases nominated as Rudnik I-IV. The phase Rudnik I-II characterized by the culture of Starcevo type is included in early Neolithic of Central Balkan. The culture of Rudnik I phase is defined by the red polished monochrome, barbotine and impreso ceramic. The dwellings of the most ancient horizon have been constructed on the ground, with woody frames, no floor.

Considering the chronology of this layer M. Garaœanin, thinks that the phase Rudnik I corresponds to the protostarcevo phase, but in this level of our studies, we can not ascertain if it precedes Anzabegovo I phase and is nearer Proto Sesklos, or does it represent a later culture. Rudnik II phase is characterized by the same elements of precursor phase. It appears for the first time the fine painted ceramic of Starcevo type IIa-b.

Starcevo IIa phase is characterized by white painted ceramic and linear-geometric motifs, whereas II b phase with brown painted ceramic on red background and with geometric and curb linear motifs. (*pl. I, 1*). The objects related with the spiritual part of Neolithic habitants as the cult's tables, the anthropomorphic figurines are the main characteristics for this phase.

This phase coincides with the largest expansion of Stracevo culture into south direction represented by Rudnik II, Vlashnja, Kolsh I horizons etc. The above analogies show that in this ancient period of prehistoric development all Rrafsh i Dukagjinit region was a

part of the wide Central-Balkan area of ancient Neolithic of Starçevo I-II type.

Rudnik III phase is characterized by fine brown color painted ceramic with linear and curb linear motifs, while the white color disappears. (*Pl. I, 2*).

In Rudnik IV phase, in coarse ware, it appears the organized barbotine as well the combination of different plastic decorative techniques. The decoration with graphic spiral is presented for the first time in fine painted ware. With these morphologic and decorative elements we believe that Rudnik III-IV phases should be linked with the ending period of Early Neolithic of Central Balkan. It combines the elements of cultural groups of central-Balkan Neolithic, Adriatic and Thessalonians (Sesklo III a)

Vlashnja is the second important settlement of ancient Neolithic of Drini i Bardhë valley. It is extinguished for a long habitation continuity since Early Neolithic to the mediaval period.

The early Neolithic civilization in Vlashnje is developed through two successive phases, Vlashnje I a and Vlashnje I b, which coincides to the Starçevo II a-b phases (*Pl. II, 1-10, III, 1-8*). The middle neolithic civilization in Kosovo plain is stratigraphically known by the systematic excavations in Tjerrtore I a-b (Prishtinë), Fafos I a and Zhitkovac II (Mitrovicë), whereas in the Rrafshi i Dukagjinit by Vlashnja II near Prizren (*Pl. IV, 1-12, Pl. V, 1-12*) as well as by the superficial finds in Pogradec settlement (Klina).

The late neolithic civilization in Kosovo plain is known stratigraphically in Fafos II, Vallaç, Bardhosh etc, whereas in Rrafshi i Dukagjinit by Reshtan, Hisar I and Vlashnja III sites Reshtan settlement is situated in a flat alluvium field, in the left of Topluga river, near Suhareka town. The cultural layer with a thickness of 2.00 m belongs to the Middle Neolithic of Adriatic type. The physiognomy of the culture is defined by the ceramic where dominates biconical vessels; bowls with S-shape profile as well the bowls with short or long cylindrical neck in grey color and black varnished wares.

The main decorations are the plastic ones and those with geometric incision where it is encountered the white incrustation. (*Pl. VII, 1-6*). The altars decorated with incision and other elements of the Adriatic culture are the main characteristics of this culture. The culture of Reshtan is closely related with Danilo cultural group of Late Neolithic. Besides these elements, elements of Vinça culture are also present, considering the good geographical position between Reshtan among two cultural simultaneous groups. The western adriatic elements are present in Vlashnja III too (*Pl. VI, 1-14*), as well as in Hisar I (*Pl. VIII, 1-9*), but they have infiltrated till in Kosova plain, such as Tjerrtore II near Prishtina, which represent up till now the eastern border of Danilo culture spreading in Kosovo.

The eneolithic civilization in Kosovo is better represented in the multilayer settlement of Hisari of Suhareka and Gadime near Lipjan, as well as the deposit of Glladnica (Glladnicë II) near Prishtina. Furthermore the elements of this culture are encountered in a thin layer of Hisar settlement of Kasterc as well in the multilayer settlement of Vlashnja IV (Prizren). Few tracks of this culture are recently encountered in Zatriç cavy settlement (Rahovec). The settlements of this period are situated in the fluvial terraces with natural protection as well in caves.

Hisar is one of the most representative centers of eneolithic in Kosovo. The first systematic excavations in this settlement were carried out during the years 1961-1963, headed by J. Todoroviæ followed by those of J. Glisiæof 1978 and 2003-2004 excavation, carried out by a staff of archaeologists from Albania and Kosovo. According to the recent excavations 9 dwelling horizons, chronologically connected with eneolithic period, early bronze and iron period are clearly distinguished in Hisar.

The phase Hisar I correspond to the end of the neolithic civilization with elements of the late adriatic neolithic, similar to Reshtani culture and Danilo IV-Havr -Lisiçiç as well to the late Vinæa one. The phase Hisar II a-b belong to the Bubanj-Hum I a-b phases of southern Morava, as well as Gadime e Epërme near Lipjan too. Hisa II c coincides to the phase I of Baden-Kostolac group of Danube area. The late elements of Baden are present in the cave settlement of Zatriç near Rahovec. The Kostolac elements are missing in the Vlashnja IV eneolithic layer, which contains mainly the Bubanj I b phase elements.




1




2

Rudnik, Sh. 1:2

TAB. II




Vlashnje Ia, Sh. 1:2




Vlashnje Ib, Sh. 1:2

TAB. IV




Vlashnje II, Sh. 1:2




Vlashnje II, Sh. 1:2


TAB. VI




Vlashnje III, Sh. 1:2



TAB. VIII




Hisar I, Sh. 1:2




Hisar Ila, Sh. 1:2


TAB. X




Hisar Ila, Sh. 1:2





Hisar IIb, Sh. 1:2






Hisar Ilc, Sh. 1:2





Vlashnje III, Sh. 1:2

TAB. XVI



TAB. XVII

